

**Fushata**  
Cep më cep  
për PO-në  
evropiane



**VITI SHKOLLOR**

Për më shumë  
se 20 mijë  
fëmijë bie zilja  
për herë të parë



Liga e  
Kombeve,  
një shans  
i madh  
për ne



# Koha



**Brukseli,**  
qyteti i  
spiunëve

## AKTUALE

Për një vit  
mbyllen  
2500 firma



Përfundimisht me vitin 2017 kemi rritje për 3.2 për qind të firmave që kanë bankrotuar apo mbi 2500 firma kanë pushuar së funksionari gjatë vitit të kaluar. Kështu rezulton Raporti për stabilitetin financiar në Maqedoni i Bankës Popullore të Maqedonisë për vitin 2017, sipas të cilit, krahasuar me vitin 2016...

## GLOBI

Rrini në  
vendet tuaja,  
rrugët e  
Gjermanisë  
nuk janë  
me flori!

## RAJON

Nuk ka  
kohë për  
kthim prapa,  
marrëveshja e  
domosdoshme



PAS SMILLKOVËS, NJË TJETËR FILM PROVOKUES PËR UÇK-në

# 300 MIJË EURO PËR TË NXITUR URREJTJEN



Projekti filmik ka fituar në vitin 2015 në Agjencinë e Filmit si filmi më i paguar, dhe për të cilin kjo e fundit ka akorduar një fond maksimal 300 mijë euro. Xhirimet e filmit filluan dy vjet pas financimit të këtij projekti, në vitin 2017, në fshatin Pomenovë, në komunën e Çashkës, aty ku zhvillohen pjesa më e madhe e skenave me ushtarë të UÇK, që terrorizojnë njerëz nën tytën e pushkëve, gra e të moshuar

## Doktor "Google" më i vizituar se doktori specialist!

Shkup, 2 shtator - Kërkimi i vazhdueshëm për informacione në internet mbi sëmundjet ka bërë që shumë njerëz të heqin dorë nga doktori dhe me këtë, të rrezikojnë edhe shëndetin. Alarmi është ndezur me rritjen e madhe të faqeve në internet – gjoja të shëndetësisë dhe shit-blerjet online të ilaçeve, pa kontroll paraprak të institucioneve shëndetësore si dhe pa adresë të saktë të shitësit në internet. Shumë

qytetarë thonë se vizitojnë faqet e internetit për një dietë, për të trajtuar infeksione të ndryshme, për të trajtuar ekzemën, e cila është forma më e mirë e qetësisë ose për një gjumë më të mire në orët e vona të natës. Mjekët nuk përjashtojnë faktin se pacientët duhet të marrin informacionin në libra dhe më pas të kërkojnë këshilla nga profesionistët, por jo edhe të konsumohen ilaçe...



SI SHKRUANIN PARAARDHËSIT

# ARMIQT' E SHQIPËRISË



Faik KONICA

A ka gjë më të turpeshmë, më të unjtë se historia e këtij kombi që - për pakë të qelbur ergjënt - shet mish njeriu në ç' do luftë, edhe kujt s'i erdhi dëshërim, nga aqë qint vjet që e shkelin edhe e kurvërojnë të huajtë

Të gjith' ata që kanë njohur mirë vëndin tonë, shkrojnë që dheu i Shqipërisë munt të japë bukë një zet mijon shpirtëve: e dini që jemi tre mijonë edhe që dy mijonë prej nesh ngordhin urije; Shkrojnë që Shqiptarët janë miaft të mëncurë me punuem për mirësin' edhe për dritën e gjithë njerëzisë: e dini mirë që Shqiptarët të mësuarë janë më të rallë se fjalë të vërteta në gojë të priftit. Cilët prejtin bukën e barkut, cilët prejtin bukën e mëndies?

Kemi armiq. Për atë, të gjithë bashkohen në një zë. Vetëm për këtë ndahen, që të gjithë nuk tregojnë një armik. Ca zgjatin gjishtin drejt dhelpepëris' e Grekut, ca dëftojnë gjarpërimin e Shqevet, ca të tjerë emërojnë, me zë të unjtë, trashërin' e Halldupëve. Kur dëgjojmë të tilla, neve na vjen një i pambajtur gas. Armiqt' e Shqipërisë janë Shqiptarët, jo të tjerë. Shqiptarët kanë shkruar me gjakn' e tyre më tepër se një faqe në histori të Evropës. Nga më të vogëlat të trazuarat gjer në luftat më të gjakta, Shqiptari ka hequr hark, vetëtitor kordhë e zbrasur pushkë.

A ka gjë më të turpeshmë, më të unjtë se historia e këtij kombi që - për pakë të qelbur ergjënt - shet mish njeriu në ç' do luftë, edhe kujt s'i erdhi dëshërim, nga aqë qint vjet që e shkelin edhe e kurvërojnë të huajtë, s'i erdhi dëshërim të japë dy pika gjak për lirin' e vetëhesë? Të dojin Shqiptarët lirin' e Shqipërisë, lehtazi e bëjin; po rinë të pa-tundurë, edhe andej dëftojnë që s'e duan Shqipërinë, dëftojnë që janë armiq' e saj. Dëgjoni mirë, në mos e dini: S'janë armiq vetëm duke ndënjur duartë në gji, po ditë për ditë edhe ndryshe punojnë kundër mëmëdheut. Sa të fëlliqura shkrohen në Greqi, a tjetërkund, kundër të mjerëve Shqiptarëve, kundër Paloarvanitëve, sa kanune linden në Stamboll për të therur Shqipërinë (Pis-Arnautluk), të tëra Shqiptarët i nxjerin.

Shkaku i këtyre të ligave është se Shqiptarët s'kanë shpirtin miaft të lartë për të dashur lirinë; Shqiptarët psherëtitin nat' e ditë pas orës tek do të mundin të jenë fare robër nënë Turkun a nënë Grekun, të hidhen në gjunjë përpara Gjorgos, t'i qërojnë thonjët më gjuhë. Veç zakonës, qi ryri në gjak të Shqiptarëve, të veshin gjithënjë lëkurën e Turkut, e Grekut a nonji tjetërit zotit, është dhe shkaku i gjuhëve e i besave. Ata prej nesh që s'e kuvëndojnë shqipen, arisin lehtazi të besojnë që s'janë Shqiptarë. Ç'ka të bëjë gjuha në këtë punën? Helvecianët, për tregim, kuvëndojnë ca frëngjishten, ca gjermanishten: po janë një komb. Pse? Se kanë një rrëzë, edhe kombi është punë rrëzë, jo gjuhe.

Tjetëri shkak është që ca prej Shqiptarëve janë të sunetisurë, ca të pagëzuarë. Këto të dy punërat miaft për të qeshur janë, edhe - në qoftë që nonji këndonjës nuk i njuh - ja, shkurt, qysh bëhen. Kur aritet një djalë shtat a tet vjeçar, i at' i tij fton miqtë, han' e pinë dhe këndonjë; pastaj, duke rënë vjolitë, një maskara i qaset të gjorës foshnjës - e cila ulërin dhe përpiqet - edhe me një gërshtë në dorë i pret një thellë mish te një vënt që është turp t'a emëronj. Janë Shqiptarët qi s'e bëjnë këtë punën; por ata, kur lindet një djalë, ja shpian një prifti mjekërqelburi, i cili e mer edhe e klet lakuriq brënda në një magje plot me ujë. Mos e mirni shtrëmbër mëndimin tim, u lutem; unë s'kuvëndoj kundër këtyrave punërave: të mira a të liga, ç' do njeri është i lir t'i besojë edhe t'i mbajë. Vetëm një pjetje ju kam për të kërkuar, duke falur nderjes: A kuptoni si munt t'i ndrohet rrëza një njeriut sepse - kur qe djalë - i këputnë një copë mish a e vunë brënda në një magje? Mua s'm'a pret mëndia.

## ARTISTËT E SHEKULLIT

"Popull i gjorë, i cili vetëm dy gjërave u gëzohet: vesës së verës dhe xhunglës. Të tjerët e shijojnë muzikën, artin, ujin, ajrin, rregullin, punën, pushimin... Krijesa të llastuara, ne, të cilët detyrohemi edhe ajrin ta thithim pak nga pak, përmes ventilatit që të tjerët e kontrollojnë sipas qejfit të vet, kur t'u teket t'i qesin pak helm, e kur t'u teket ta pastrojnë dhe t'u falënderohemi paq... Kush e di se kujt duhet t'i falënderohemi për këtë pjesë teatrale shoqërore? Ne nuk ngopemi dot me ajër, as me ujë, as me rregull e pastërti, kërkojmë mbrojtje nga qentë endacakë mu në mesin e një udhëkryqi të madh, gjithmonë kthejmë kokën anësh e pas nga frika, sikur na ndjek djalli, përse vallë? Rrugë me rrezik të madh edhe në vijat e bardha, diskurse kuturu nga injorantët e sotëm, të cilët na kanë hyrë thellë nën lëkurë, kurse ne nuk dimë sa kokë kemi? Dy, katër, pesë, shtatë, nëntë? Dhe as nuk na intereson fare sa! Ky shekull është i shtirësve, artistëve të lindur të përfitimit... në shoqëri, politikë, biznes, arsim, kulturë, sport e gjetiu. Shtirësit e shekullit nuk ndjenjë, as shohin dhe dëgjojnë. Ata janë të ftohtë akull, në venat e tyre nuk rrjedh gjak, as djersijën, as sëmuren dhe as skuqen. Nuhatjen e kanë armën e tyre më të fortë... nuhasin larg, shumë larg, edhe përtej maleve e brigjeve, kur është fjala për interesin e tyre. Vetëm para gjumit, ne jemi krejtësisht vetvetja, kur lajmë dhëmbët para pasqyrës së banjës dhe e pikasim se sa jemi zbardhur... të nesërmen turravrap te berberi, të lebetitur se shpejt nuk do të na njohë më askush", shkruan në profilin e tij në Facebook, profesori universitar Arbër Çeliku.

## ME "MIQËSI" TRADICIONALE, S'DO MUNDEMI TA RUAJMË MIQËSINË AMERIKANE

"Ideja e proamerikanizmit (që e ushquu ëndrra amerikane), neve shqiptarëve të Ballkanit duhet të na frymëzoj dhe inspiroj jo më nga rrafshi i vazhdimit të kultivimit të dëshirave tona për atë 'miqësinë' tonë historikisht të njohur dhe të vërtetuar si; inferiore, të dëmshme e padyshim me mentalitet robi. 'Miqësi' kjo, që më shumë ishte e prirur kah nënshtrimi e sundimi nga të tjerët, por, një miqësi e shikuar nga horizonti i një partneriteti të ri social e sidomos sish politik e ushtarak... Sepse, vetëm në këtë mënyrë ne kryejmë dy obligime ndaj vetës sonë kolektive dhe ndaj mikut të vërtetë: Njërin, sepse kështu fillojmë t'ia heqim vetës atë hipotekën e "gogolit për inferioritetin tonë historik", që na u amputua padrejtësisht më pak nga të tjerët, dhe më shumë nga vetja jonë. Dhe tjetrin, sepse ka të bëjë me hisen tonë që na takon historikisht, gjeografikisht, e demografikisht në këto hapësira den baba den... Krenaria (ëndrra) amerikane, u (ri)ndërtua dhe u (ri)kultivua mu përmes modelit të partneritetit me të tjerët, dhe përmes liritimit nga kompleksi i inferioritetit që na e amputoi 'miqësia' tradicionale", shkruan në profilin e tij në Facebook, sociologu kosovar, Fadil Maloku.

## MEDIACitate

### JO KOMPROMISE ME BEQË DËMTOJNË VENDIN!

Ethet e "Brexit" kanë nisur të mbërthejnë britanikët dhe kryeministrja Theresa May, e gjendur në qendër të kritikave dhe sulmeve për mungesën e një marrëveshje për daljen nga BE, është detyruar t'i dalë përpara popullit të saj duke insistuar se ajo nuk do të mund të detyrohet të stërhollojë planin e saj për largimin gjatë negociatave me Bashkimin Europian. Duke shkruar në Sunday Telegraph, kryeministrja thotë se ajo "nuk do të shtyhet" drejt kompromiseve për ndryshime të mundshme në marrëveshjen e saj, të cilat nuk janë në "interesin kombëtar". Por May gjithashtu paralajmëron se nuk dorëzohet përballë atyre që bëjnë thirrje për një referendum të dytë për "Brexit", pasi këtë e konsideron një "tradhti të madhe ndaj demokracisë dhe besimit tonë". "Vota Popullore", një grup ndërpartiak që përfshin disa deputetë britanikë, që ka nisur një turnë mbarë vëndin duke bërë thirrje për një votim publik për marrëveshjen përfundimtare të Brexit. Mbretëria e Bashkuar është në hapat e fundit të rrugës që do ta nxjerrë jashtë BE-së më 29 mars dhe qeveria më parë ka përjashtuar një referendum të dytë. Kryeministrja May ndërkohë shkruan se muajt e ardhshëm janë "kritik në formësimin e të ardhmes së vëndit tonë", por është "e qartë" për misionin e saj në përmbyshjen e "vendimit demokratik të popullit britanik". Ajo shton se pas marrëveshjes së "Checkers" në korrik - që çoi në dorëheqjen e dy ministrave të kabinetit - është bërë "përparim i vërtetë" në negociatat e Brexit. Ndërsa ka ende shumë negociata për t'u finalizuar, May shkruan: "Ne duam të bëjmë një marrëveshje të mirë dhe jemi të sigurt se mund ta arrijmë". Qeveria është duke u përgatitur edhe për një skenar pa marrëveshje, edhe pse kjo do të krijonte "sfida reale për Mbretërinë e Bashkuar dhe BE në disa sektorë", thotë May. Por kryeministrja shton: "Do të kalojmë sfidën dhe do të vazhdojmë lulëzimin".


(Sunday Telegraph, 2 shtator)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

### KUSH ISHTE LEONIK TOMEU?

Leonik Tomeu (1456-1531) ishte humanist, filozof, pedagog, letrar e historian. Lindi në Venedik në një familje që kishte mërguar nga Durrësi. Në veprat e tij përmend prejardhjen e vet shqiptare. Studimet i kreu në Francë, në shkollën "aristoteliane". Në vitet 1504-1531 në Venedik ishte një ndër intelektualët më të njohur dhe më pas u bë një nga drejtuesit e shoqërisë "Shkolla e shqiptarëve", qendër e

kulturës shqiptare në mërgim. Më 1497 Leonik Tomeu u emërua profesor dhe titullar i katedrës së filozofisë në Universitetin e Padovës. Ishte njohës i thellë i gjuhëve e i letërsive klasike dhe i mendimit përparimtar të lashtësisë.



Zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani ndërkohë paralajmëroi se BDI më 10 shtator do ta fillojë fushatën për Referendumin. Në suaza të saj, siç tha ai, qytetarëve do t'u sqarojnë sfidat para të cilave ndodhet vendi dhe përfitimet nga anëtarësimi i Maqedonisë në NATO dhe BE

Koha

Evis HALILI

Shkup, 2 shtator - Po intensifikohet fushata "Dil PËR Maqedoni evropiane" për Eferendumin e caktuar për më 30 shtator të koalicionit "Për Maqedoni të përbashkët", të cilin e përbëjnë 30 subjekte politike dhe qindra organizata të ndryshme. Fushata ka vazhduar nëpër qytete të ndryshme të vendit, ku në Dojran dhe Vallandovë ishte kryeministri Zoran Zaev, ndërsa ministri i Punëve të Jashtme e vizitoi Tetovën. Zaevi në tubimin në Vallandovë porositi se me Eferendumin në vitin 1991 e fituam, ndërsa me Referendumin në vijim, më 30 shtator, duhet ta çimentojmë pavarësinë e Maqedonisë.

"Atëherë e fituam, ndërsa tani duhet ta sigurojmë të ardhmen e Maqedonisë me kërcim kuantik në BE dhe NATO përmes pranimi të marrëveshjes me Greqinë. Me këto dy marrëveshje tani kemi dorë të zgjatur nga të gjithë. Greqia fitoi erga omnes për emrin, ndërsa ne fituam identitet erga omnes. Patriotizëm i vërtetë është të sillim vendim i drejtë dhe të sigurohet shteti dhe e ardhmja e fëmijëve

INTENSIFIKOHET FUSHATA PËR REFERENDUMIN

# CEP MË CEP PËR PO-në EVROPIANE



tanë. Prandaj jam i bindur se do të sjellim vendim të fuqishëm dhe se më 1 tetor kur do të zgjohemi do ta shohim shtetin të reshtuar në rrugë të drejtë", tha Zaev.

Duke folur për marrëveshjen me Greqinë, në tubimin në Dojran, Zaevi theksoi se mu këtu është vendi ku me fqinjët jugorë është arritur njohja e gjuhës maqedonase. Përmes marrëveshjeve me Bullgarinë dhe Greqinë, theksoi ai, tashmë nuk kemi probleme me njohjen e vendit tonë, popullit, identitetit dhe gjuhës. "Fituam miq të cilët jam i bindur se do të na mbështesin fuqishëm në rrugën tonë dhe përcaktimin për Maqedoni evropiane. Integrimi ynë në BE dhe në NATO përmes pranimi të marrëveshjes me Greqinë është shumë i rëndësishëm për Maqedoninë dhe prandaj jam i bindur se më 30 shtator do të sjellim vendim të guximshëm", potencoi Zaev në Dojran.

Ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, i cili fushatën për Referendumin e filloi nga Tetova, porositi se nuk ka kurrfarë dyshimi se shumica e qytetarëve do të dalin dhe do të rrumbullakojnë PO dhe shtoi se ai më 30 shtator me një rreth të fuqishëm dhe të madh do të rrumbullakojë PËR. Ai theksoi se ndryshimet kushtetuese në pajtim me marrëveshjen me Greqinë do të hyjnë në fuqi vetëm nëse ratifikohet marrëveshja edhe nga pala tjetër. Zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani ndërkohë paralajmëroi se BDI më 10 shtator do ta fillojë fushatën për Referendumin. Në sua-

za të saj, siç tha ai, qytetarëve do t'u sqarojnë sfidat para të cilave ndodhet vendi dhe përfitimet nga anëtarësimi i Maqedonisë në NATO dhe BE.

"Më 10 shtator do të fillojmë komunikim aktiv me qytetarët në mënyrë që t'u sqarojmë sfidën para së cilës ndodhet shteti dhe të ardhmen e gjeneratave që vijnë, si dhe atë çka fitojmë si shpërblim nëse arrijmë Maqedoninë ta bëjmë anëtare të aleancës më të madhe ushtarako-politike dhe të na gjejë në të periudha e sfidave të rënda në tërë rajonin", tha zëvendëskryeministri Osmani. Ai informoi edhe se BDI për atë qëllim tashmë ka formuar shtab qendror, si dhe se do të ketë edhe shtabe të degëve dhe bashkësive lokale.

za të saj, siç tha ai, qytetarëve do t'u sqarojnë sfidat para të cilave ndodhet vendi dhe përfitimet nga anëtarësimi i Maqedonisë në NATO dhe BE.

## Pas Referendumit dihet data e Kongresit të pestë të BDI-së

Shkup, 2 shtator - Këshilli i Përgjithshëm i Bashkimit Demokratik për Integrim në mbledhjen e mbajtur të premten në Shkup njëzëri miratoi vendimin për shtyrjen e Kongresit të pestë të partisë. Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm të Bashkimit Demokratik për Integrim vlerësuan se të gjitha kapacitetet e veta në këtë vit, BDI ia ka përkushtuar realizimit të barazisë gjuhësore, reformave urgjente, marrëveshjes së fqinjësisë së mirë me Bullgarinë, mbylljes së kontestit me Greqinë, marrjes së ftesës për anëtarësim në NATO dhe datës për fillim të negociatave me Bashkimin Evropian. "Rrumbullakësimi i këtij procesi nëpërmjet të mbajtjes së suksesshme të referendumit dhe ndryshimeve kushtetuese është i një rëndësie absolute prioritare për Bashkimin Demokratik për Integrim dhe qytetarëve. Pas përmbylljes së suksesshme të këtyre detyrimeve dhe pritjeve të qytetarëve, Këshilli i Përgjithshëm i Bashkimit Demokratik për Integrim do të takohet përsëri për të sjell vendim për mbajtjen e Kongresit dhe për të hartuar strategjinë e ndërtimit të BDI-së për dy dekadat vijuese", thuhet në komunikatën e BDI-së.

## Referendumi në Maqedoni "ndez" sërish reagimet në Greqi

Athinë, 2 shtator - Afrimi i 30 shtatorit, ditës së referendumit që do të mbahet në Maqedoni për të aprovuar ose jo marrëveshjen me Greqinë për emrin, ka rritur përsëri reagimet e grekëve, sidomos në zonat veriore të vendit. Shumica e protestave të javës që vjen në Selanik dhe qytetet e tjera rreth tij janë ato të organizuara nga grupe që kundërshtojnë marrëveshjen që nënshkruan Athina dhe Shkupi në Prespë, disa muaj më parë.

Reagimet që ishin shuar gjatë muajve të verës filluan përsëri të përshkallëzohen, sidomos pas deklaratave të ministrit të Jashtëm, Nikola Dimitrov, në Parlamentin Evropian. I pyetur nga eurodeputetët konservatorë të Greqisë, ai ka theksuar se "vendi i tij do të quhet Republika e Maqedonisë Veriore dhe qytetarët e saj do të jenë maqedonas, të cilët do të flasin gjuhën maqedonase". Janë pikërisht gjuha dhe identiteti, dy nga

pikat kryesore të kësaj marrëveshjeje, që për një pjesë të konsiderueshme të grekëve nuk pranohen.

Në shtypin e djathtë grek riprodhohen deklaratat e fundit, por edhe të mëparshme të kryeministrit Zaev, në të cilat ai thekson ato çfarë fiton vendi i tij me këtë marrëveshje, ndaj dhe kërkon nga bashkëqytetarët e tij pjesëmarrje në referendum dhe aprovimin e saj. Sondazhi i disa ditëve më parë tregoi se, 57% e të intervistuarve janë shprehur se do të votojnë pro marrëveshjes, e cila do të sjellë integrimin e vendit në NATO dhe BE, e ky rezultat ka shkaktuar buzëqeshje në Shkup. Ndërsa në Athinë, ministri i Mbrojtjes, njëkohësisht kreu i partisë së aleancës qeveritare "Grekët e Pavarur", ka paralajmëruar menjëherë pas riformatimit të kabinetit që ka bërë kryeministri Tsipras se do ta rrëzojë qeverinë, nëse marrëveshja vjen në Parlamentin grek, duke mos e aprovuar atë.



## Referendumi i suksesshëm hapë perspektivat e shtetit

Beograd, 2 shtator - Goran Svilanović, ish ministër i Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, njëherësh sekretar i përgjithshëm i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal me seli në Sarajevë, ka dërguar porosi deri te qytetarët e Maqedonisë për Referendumin e 30 shtatorit. "Gjithsesi se Referendumi është çështje kombëtare. Por, vetëm referendumi i suksesshëm do të hapë perspektivë dhe potencial të madh. Me të vetë qytetarët do të kenë mundësi të vendosin pikë në kontestin që mbi 25 vite e bllokonte përparimin e vërtetë dhe proceset integruese në vend". Marrëveshjen që e arritën kryeministrit Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras, sipas tij, është i guximshëm, i madh, historik dhe inkurajues për tërë rajonin, sepse jep potencial të freskët, jo vetëm për bashkëpunimin në integrimet euroatlantike, por edhe për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit, si dhe tërë rajonit. "Pres pas referendumit të suksesshëm, vendet anëtare të Bashkimit Evropian t'i operacionalizojnë konkluzionet e Këshillit Evropian për fillim të negociatave. Për pritje është procesi i negociatave të rrjedhë me tempo solide për shkak të faktit që vendi deri tani arriti nivel të lartë të harmonizimit në ligjvënien me BE-në. Svilanović konsideron se e rëndësishme është që qytetarët ta njohin vlerën e madhe të këtij referendumi, duke i marrë parasysh perspektivat dhe mundësitë që i sjell Bashkimi Evropian, dhe në të të sjellin vendim përgjegjës për të ardhmen e tyre dhe për të ardhmen e gjeneratave të ardhshme. "Strategjia evropiane për zgjerim e publikuar në shkurt të këtij viti është qartë e pamundur ndërsa integrimi në BE me konteste bilaterale të pazgjidhura, që do të thotë se imperativ është zgjidhja e përhershme e problemit kompleks bilateral.

Nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës thonë se shkollat janë të përgatitura për nisjen e vitit shkollor. Gjithsesi, sipas paralajmërimeve, disa nxënës dy javët e para nuk do të kenë një pjesë të librave. Sipas MASH-it, shtëpitë botuese nga mesi i shtatorit kanë për obligim ti distribuojnë librat në të cilat shkruhet (fletore pune). Sipas të dhënave zyrtare, këtë vit në klasë të parë do të shkojnë rreth 20.000 fëmijë

Koha

Aida XHONI

NIS VITI SHKOLLOR 2017/2018

# PËR MË SHUMË SE 20 MIJË FËMIJË BIE ZILJA PËR HERË TË PARË



vit. Me nënshkrimin e marrëveshjeve mes Ministrisë së Arsimit dhe Sindikatës, parashihet që paga minimale në arsimin fillor të mos jetë më poshtë se 12.700 denarë, ndërsa në atë të mesëm të mos jetë më poshtë se 13.100 denarë. Ndërkaq shumë premtime të funksionarëve për përmirësimin e gjendjes së shkollave, nuk kanë gjetur zbatim. Edhe viti akademik 2018-19 do i zë shumë shkolla në mungesë të kushteve elementare, nxënës që nuk kanë transport apo fshatra që nuk kanë fare shkolla.

Shkup, 2 shtator - Pushimet verore kaluan shpejt dhe shkolla nisi përsëri për mijëra nxënës që i janë drejtuar sot bankave të institucioneve arsimore në të gjithë vendin. Përveç nxënësve, edhe prindërit janë në ethe dhe fillimit të vitit shkollor. Për dallim nga fëmijët, të cilët kanë për obligim të mësojnë, të rriturit mendojnë për furnizimin me pajisjet shkollore, veshje, çanta... Është e panjohur se sa do tu kushtojë kthimi i nxënësve nëpër bankat shkollore. Nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës thonë se shkollat janë të përgatitura për nisjen e vitit shkollor. Gjithsesi, sipas paralajmërimeve, disa nxënës dy javët e para nuk do të kenë një pjesë të librave. Sipas MASH-it, shtëpitë botuese nga mesi i shtatorit kanë për obligim ti distribuojnë librat në të cilat

shkruhet (fletore pune). Sipas të dhënave zyrtare, këtë vit në klasë të parë do të shkojnë rreth 20.000 fëmijë.

## DITË E LIRË PËR PRINDËRIT!

Ministri e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS), bëri me dije se kujt i takon sot ditë e lirë nga puna për të dërguar fëmijët në shkollë. Ditë të lirë nga puna për të dërguar fëmijën në klasë të parë u takon nëpunësve (administratorëve). Kjo u është e garantuar me marrëveshjen kolektive. A do të jenë të lirë nga puna dhe si do të lirohen ato që punojnë në sektorin privat varet nga pronarët apo shefat e tyre?

Nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale sqarohet se në pajtim me Marrëveshjen e përgjithshme kolektive në sektorin publik, punë-

tori ka të drejtë për pushim të paguar (një ditë të lirë) në ditën e parë të fillimit të vitit shkollor për fëmijën e tij, transmeton Koha. Nga atje theksojnë se kjo mungesë, si edhe rastet tjera familjare të pushimit të paguar për rrethana personale dhe familjare, realizohen pavarësisht nga kërkesa i procesit të punës. Marrëveshja kolektive në sektorin privat, thonë nga Ministria, nuk përmban rregullativë ku parash ditë të lirë as për ditën e parë në shkollë e as në kopsht. Ajo, siç sqarohet juristët, do të thotë se nuk ndalohej t'u jepet ditë e lirë punëtorëve të sektorit privat, por mund edhe të refuzohet. Në firmat private gjithçka realizohet në marrëveshje me punëtorin dhe punëdhënësit. Ata mund të merren vesh për çdo gjë që nuk është e ndaluar me ligj.

Vitin e kaluar, për vitin shkollor 2017/2018 ishin regjistruar 20.437 fëmijë në klasë të parë, ndërsa në Shkup rreth 600.

## 5% PAGA MË TË LARTA PËR MËSIMDHËNËSIT!

Nga ky muaj, të gjithë punonjësit e arsimit fillor dhe të mesëm, do të kenë rritje të pagave prej 5%. Kjo u arrit me firmosjen e marrëveshjes me Ministrinë së Arsimit dhe Sindikatës së Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, javën e kaluar. Ministri i Arsimit, Arbër Ademi, tha se rritja prej 5% është vetëm një fillim i mirë dhe se do të punojnë që viteve në vijim të përmirësojnë gjendjen sociale të arsimtarëve.

Rritja e pagave të punonjësve të arsimit për 5%, qeverisë do t'i kushtojë rreth 10 milion euro shtesë në

## TRANSPORT FALAS PËR TË GJITHË!

Risi në vitin e ri shkollor do të jetë transporti falas i gjithë nxënësve nëpër shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit, pavarësisht se sa afër/larg banojnë nga shkolla ku mësojnë, tha Petre Shilegov, kryetar i Qytetit të Shkupit. "Deri tani, transportin pa pagesë e kanë shfrytëzuar rreth 20.000 nxënës të shkollave të mesme që jetojnë rreth 2.5 kilometra më larg se shkolla ku kanë ndjekur mësimet. Nga ky vit shkollor, transport falas do të mund të shfrytëzojnë plus 2 mijë nxënës tjetër, përkatësisht të gjithë nxënësit pa përjashtim", tha Shilegov. Mjetet shtesë për transportin falas të nxënësve janë siguruar nga buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018.

ÇAIRI DHE TETOVA GATI PËR FILLIMIN E VITIT SHKOLLOR

## DEZINFEKTOHEN SHKOLLAT, HIGJIENA NË NIVEL

Shkup, 2 shtator - Zyrtarë komunal të arsimit në Komunën e Çairit kanë përfunduar dezinfektimin e të gjitha objekteve shkollore. Njëjtë ka vepruar edhe Komuna e Tetovës, ndërsa dezinfektim është kryer edhe në çerdhet dhe kopshtet e fëmijëve. Siç njoftojnë për gazetën KOHA nga Komuna e Çairit, dezinfektimi dhe pastrimi i objekteve është kryer si gjithmonë, në kuadër të procedurave të rregullta vjetore. "Për sa i përket procesit të deratizimit, dezinfektimit dhe dezinfektimit, Komuna e Çairit ka realizuar procedurën për furnizimi publik, procedurën e rregullt vjetore. Pas përzgjedhjes së operatorit ekonomik, menjëherë janë marrë masat e nevojshme që të bëhet dezinfektimi i kopshteve dhe shkollave fillore për fëmijët në territorin e Komunës së Çairit. Procesi ka përfunduar dhe nxënësit në fillimvitin shkollor,

mund të hyjnë në hapësirat e dezinfektuara dhe të pastra shkollore", thotë Kushtrim Alla, zëdhënësi i Komunës së Çairit. Sipas tij, kjo masë është e obligueshme në shkollat fillore, kopshtet dhe zbatohet çdo vit.

"Përveç kësaj, është ndërmarra masa edhe për pastrimin e gjithë territorit të Komunës në bashkëpunim me ndërmarrjen publike të Higjienës Komunale dhe ndërmarrjen publike Parqet dhe Gjellërimet", tha Alla. Në ndërkohë, kryetari i Këshillit lokal socio-ekonomik në Tetovë, Ahmed Qazimi, thotë për gazetën Koha se periudha e pushimeve verore në të gjitha shkollat e Komunës së Tetovës është shfrytëzuar për një gamë të gjerë punësh, investimesh, të cilat shkojnë në drejtim të përmirësimit të kushteve për nxënësit, respektivisht për krijimin e një ambienti sa më të favorshëm mësimor.



"Ky cikël investimesh ka filluar që para 5 vitesh dhe secilin vit, në secilin shkollë bëhen investime të shumanshme, renovime, pajisje me mjete mësimore, pajisje me teknologji të reja në procesin mësimor si dhe intervenime brenda dhe jashtë shkollës në funksion të krijimit të kushteve sa më optimale. Cikli i investimeve në shkollat e komunës sonë, në secilin vit përmbillet me dezinfektimin dhe deratizimin e

objekteve shkollore, që realisht paraqet një preventivë efektive për virozët e ndryshme të mundshme", thotë Qazimi. Sipas tij, ky proces nënkupton edhe ngritjen e higjienës në nivele shumë më të larta, në mënyrë që nxënësit të kenë mbrojtjen e duhur nga viruset e mundshme.

"Dezinfektimi në masë të madhe parandalon virozat, ndërkohë që nivelin e higjienës e

vendos në kushte optimale. Dezinfektimi bëhet në të gjitha shkollat e Tetovës. Me këtë ne rrisim shkallën e pastërtisë nëpër shkolla, e cila më pas mirëmbahet përgjatë tërë vitit shkollor. Ky është një proces i domosdoshëm, sepse me këtë krijohet qëndrueshmëri në higjienën e shkollave. Sigurisht, procesi i higjienës në shkolla vazhdon për gjatë tërë vitit, ndërsa për bazë e ka këtë pastërti në fillim të vitit, që më pas mirëmbahet me aktivitetet e përditshme", tha Qazimi.

Ndryshe, sipas mjekëve, shkollat duhet patjetër të dezinfektohen dhe kjo duhet të jetë masë obliguese dhe e patjetërsueshme që duhet të zbatohet. "Në këtë kohë, ku numri i të prekurve nga gripi ose virozët e tjera është prezent, duhet patur shumë kujdes e sidomos me fëmijët pasi ata janë më të ndjeshëm në këtë situatë", apelojnë mjekët. (D.K)

Projekti filmik ka fituar në vitin 2015 në Agjencinë e Filmit si filmi më i paguar, dhe për të cilin kjo e fundit ka akorduar një fond maksimal 300 mijë euro. Xhirimet e filmit filluan dy vjet pas financimit të këtij projekti, në vitin 2017, në fshatin Pomenovë, në komunën e Çashkës, aty ku zhvillohen pjesa më e madhe e skenave me ushtarë të UÇK, që terrorizojnë njerëz nën tytën e pushkëve, gra e të moshuar

PAS SMILLKOVËS, NJË TJETËR FILM PROVOKUES PËR UÇK-NË

# “PËRQESHJA E KRISHTIT”, 300 MIJË EURO PËR TË NXITUR URREJTJEN



Koha

Evis HALILI

Shkup, 2 shtator - Shqiptarë që terrorizojnë, vrasin, përdhunojnë... Një tjetër projekt i financuar nga Agjencia e Filmit provokon marrëdhëniet ndëretnike, me ngjarje që zhvillohen në vitin 2001 dhe skena të dhunshme ku protagonistë janë ushtarët e UÇK-së. Me regji dhe skenar nga Jani Bojaxhi dhe produksion të "Orion production", projekti filmik ka fituar në afatin e parë të konkursit të vitit 2015 në Agjencinë e Filmit si filmi më i paguar, dhe për të cilin kjo e fundit ka akorduar një fond maksimal 18 milionë denarëve (300 mijë euro).

Projekti atëherë quhej "Frymëmarrja e engjëllit" (Zdivot na angelot), ndërsa vetë filmi që ka përfunduar këtë vit, shfaqet me titullin "Përqeshja e Krishtit" (Mocking of Christ). Xhirimet e filmit filluan dy vjet pas financimit të këtij projekti, në vitin 2017, në fshatin Pomenovë, në Komunën e Çashkës, aty ku zhvillohen pjesa më e madhe e skenave me ushtarë të UÇK-së që terrorizojnë njerëz nën tytën e pushkëve, gra e të moshuar. Komandat i formacionit ushtarak i veshur me uniformën e UÇK-së është aktori Robert Ristov, i cili në trajlerin internacional të filmit, shfaqet i shoqëruar me ushtarë të tjerë që me kondakun e pushkëve thyejnë xhamat e një autobusi dhe i drejtohen pasagjerëve me fjalët "Kafshë kaurë dilni jashtë". Terrori me ushtarë të UÇK-së shfaqet edhe në sekuenca të tjera ku ata marrin peng një grup njerëzish që i përdhunojnë dhe torturojnë!

Në faqen e "Orion Production", regjisori Jani Bojaxhi ndër të tjera thotë se bëhet fjalë për një film që i dedikohet njerëzve që po kërkojnë identitetin e tyre, një rrëfim për frikën e asaj që mund të zbulojnë nga ai kërkim.

"Kam kaluar një pjesë të jetës në Greqi, por tani jetoj në Maqedoni. Më kërkuan të mobilizohesha në policinë ushtarake në verën e vitit

## PËRGJEGJËSI NGA ANËTARËT E KOMISIONIT E DERI TE QEVERIA

Kundër filmit ka reaguar edhe koordinatori i grupit parlamentar të BDI-së, Ejup Alimi. "Si deputet i Parlamentit të Maqedonisë dhe si qytetar i këtij vendi, vlerësoj që është e patolerueshme dhe nënçmuese që institucionet e shtetit të lejojnë dhe financojnë një film të ashtuquajtur që nxit urrejtje dhe mosdurim midis qytetarëve të këtij vendi. Mbështetja e filmit propagandistik dhe trushpërlarës "Përqeshja e Krishtit", dhe ku Ushtria Çlirimtare Kombëtare dhe qytetarët shqiptar paraqiten si terrorizues, dhunues dhe torturues, tregon se akoma ka të tillë që Maqedoninë nuk e dëshirojnë të integruar në strukturat euroatlantike dhe pjesë të Bashkimit Evropian. Me këtë rast, si deputet i partisë më të



madhe shqiptare, kërkoj përgjegjësi duke filluar nga anëtarët e Komisionit në Agjencinë e Filmit dhe zyrtarët e Ministrisë së Kulturës, pasi dikush e lejoi bërjen e filmit dhe më pas lejoi dhe nuk e pengoi e aq më pak pengoi publikimin e filmit propagandistik. Pres që edhe kabinetin qeveritar të reagoj menjëherë nëpërmjet të tërheqjes së këtij 'filmi', si dhe distancimit nga përbajtja skandaloze e të njëjtit. Kërkoj urgjentisht që Ministria e Kulturës dhe Agjencia për Film ta ndalojë shfaqjen dhe distribuimin e këtij 'filmi' fyes e shpifës si ndaj popullit shqiptarë, ashtu edhe ndaj pastërtisë së luftës së drejtë e të shenjtë të UÇK-së", shkruan Alimi në profilin e tij në Facebook.



"Kur dita s'kishte emër", filmi i Teona Mitevskës, bazuar në ngjarjet makabre të vitit 2012 në periferi të Shkupit, pranë Liqenit të Smillkovës ku u vranë katër të rinj dhe një peshkatar, sillte një version provokativ të masakrës për të cilën nuk ka ende as një epilog gjyqësor dhe që Agjencia e Filmit i akordoi një fond maksimal prej 500 mijë euro



Filmi është xhiruar përveçse në Maqedoni - është në dy shtete të tjera, Greqi dhe Francë dhe ekipi i aktorëve përbëhet edhe nga të huaj. Mes emrave të aktorëve maqedonase është edhe ai i aktorit Vllado Jovanovski, ihtar i VMRO-DPMNE, i cili nga fillimi i këtij viti po gjykohet për terrorizëm, si i involvuar në dhunën brenda Parlamentit më 27 prill të 2017-ës

2001, kur, shumë shkurt, por tragjikisht, ne 'luftuam' shqiptarët kundër maqedonasve. Në fund, dilemat e karaktereve të mia nuk janë vetëm të miat. Me disa prej tyre jam takuar dhe me të tjerët vetëm jemi shkëmbyer. Por me disa prej tyre ende jetoj në jetën reale. Të gjithë kundër njëri-tjetrit - Perëndia kundër të gjithëve! Në këtë mënyrë Jon përcakton problemin me Ballkanin dhe Ballkanin. A ndodh kjo histori në realitet? Po. A ekziston ky problem? Po. A mund të zgjidhet? Nuk e di. Pse ky film ka rëndësi për

mua? Arti nuk mund ta ndryshojë botën. Çfarë dua të arrij? Unë dua t'ju tregoj një histori. Është e vërtetë, beso në të", sqaron regjisori.

Filmi është xhiruar përveçse në Maqedoni - është në dy shtete të tjera, Greqi dhe Francë dhe ekipi i aktorëve përbëhet edhe nga të huaj. Mes emrave të aktorëve maqedonase është edhe ai i aktorit Vllado Jovanovski, ihtar i VMRO-DPMNE, i cili nga fillimi i këtij viti po gjykohet për terrorizëm, si i involvuar në dhunën brenda Parlamentit më 27 prill të 2017-ës.



Ky është projekti i dytë që Agjencia e Filmit financon duke nxitur urrejtjen ndëretnike.

"Kur dita s'kishte emër", filmi i Teona Mitevskës, bazuar në ngjarjet makabre të vitit 2012 në periferi të Shkupit, pranë Liqenit të Smillkovës ku u vranë katër të rinj dhe një peshkatar, sillte një version provokativ të masakrës për të cilën nuk ka ende as një epilog gjyqësor dhe që Agjencia e Filmit i akordoi një fond maksimal prej 500 mijë euro. Ky institucion edhe një vit pas ndërrimit të drejtorit dhe paralajmërimeve për reforma, skemë të re të financimit të filmit dhe përzgjedhjes se tematikave..., revizioneve për punën dhe keqpërdorimet në vite, ende nuk ka asnjë rezultat konkret dhe llogaridhënie për mënyrën sesi dhe kush po abuzon me milionat e agjencisë. Ministri i Kulturës, Asaf Ademi, në një njoftim në rrjetet sociale ka kumtuar se të hënën, së bashku me drejtorin e Agjencisë së Filmit, do të japin sqarime për këtë projekt.

"Do ta njoftojmë opinionin e gjerë se si në vitin 2015, nga garnitura paraprake, me paratë e qytetarëve u finansua xhirimi i një filmi që i ofendon vetë qytetarët. Do të njoft-

tohen qytetarët se kush lejoi financimin e këtij projekti kontravert dhe tendencioz; kush shkruajti recensionin pozitiv si dhe procedurat juridike që do të ndërmiren nga ana jonë", shkruan ministri në profilin e tij në Facebook.

RRITET NUMRI I BIZNESEVE QË BANKROTOJNË

# PËR NJË VIT MBYLLEN 2500 FIRMA

Subjektet ekonomike ekzistuese gjatë vitit 2017 shumë pak kanë pasur aktivitete punuese në tregun e Maqedonisë, gjë që ka çuar deri në rritjen e numrit të subjekteve afariste që të hapin proces falimentimi, gjegjësisht 3.2 për qind nga numri i përgjithshëm i subjekteve afariste të regjistruar në Regjistrin qendror kanë bankrotuar", thuhet në Raportin e BPM-së



Regjistrin Qendror të Maqedonisë thonë se deri në fund të vitit 2017, numri i përgjithshëm i personave juridikjo financiar ka qenë 111.307, ndërsa në vitin 2016, ky numër ishte 113.978 apo 2.671 firma më pak se viti paraprak. Ndërkaq, nga aspekti formalo-juridik, do të thotë firmat ekzistuese, raporte vjetore financiare deri të Regjistrin Qendror për vitin 2017 kanë dorëzuar vetëm 60 mijë firma. Arsytet se kemi kaq numër të firmave që mbyllet brenda një viti, sipas ekspertëve ekonomik, në radhë të parë është kriza e gjatë politike disa vjeçare që zotëroi në Maqedoni dhe e njëjta kontribuoi që shumë firma private të futen në borxhet të mëdha dhe në pamundësi për të kthyer borxhet e vjetra, morën vendimin më të dhimbshëm duke u vendosur drynin firmave të tyre. Profesori i ekonomisë pranë Kolegjit Amerikan në Shkup, Marjan Petreski, shprehet se edhe përkundër rritjes së numrit të firmave që kanë bankrotuar vitin e kaluar, kjo nuk paraqet sinjal serioz se në Maqedoni po përkeqësohen kushtet për të bërë biznes të suksesshëm.

"Megjithatë, nuk mund të anashkalojmë faktin se viti 2017 ishte një vit shumë i rëndë për të bërë

biznes sidomos në gjysmë vjetorin e parë të këtij viti. Me formimin e Qeverisë së re në qershor të vitit 2017, segmenti i të bërit biznes filloi të përmirësohet falë rritjes së optimizimit të firmave e jo si pasojë e zbatimit të masave reale nga Qeveria aktuale", thotë Petreski. Sipas Petreskit, i gjithë viti 2017 u mbyll nën ndikimin e krizës politike dhe pamundësisë që Qeveria aktuale të merr hapa konkrete të politikave ekonomike.

"E gjithë kjo u vërtetua me rritjen ekonomike prej 0 për qind në kuartalin e parë të vitit 2017. Kështu që në këtë kontekst, nuk është për tu habitur që numri i firmave të bankrotuara ka shënuar rritje. Mirëpo, ajo që është tepër brengosëse për momentin janë paralajmërimet e Qeverisë aktuale për marrjen e masave restriktive të cilat gjenerojnë efekte negative për sektorin biznesit, sidomos në sferat e tatimeve fiskale. Në qoftë se tatimi progresiv fillon të zbatohet nga janari i vitit 2019, atëherë kjo do të thotë humbje e madhe për firmat vendore, pse jo dhe shumë firma të marrin vendime që kapitalin e tyre ta dislokojnë në ndonjë shtet tjetër fqinjë", thotë Petreski. Analisti ekonomik Fatmir Bytyqi thotë se shkalla e rritjes së

firmave të bankrotuara prej 3.2 për qind gjatë vitit të kaluar nuk është dhe aq e vogël kur kemi parasysh se Maqedonia është shtet i vogël dhe se nuk ka dilema se kondicioni i firmave në Maqedoni nuk është dhe aq i mirë, porse mirë do të ishte të zbulohen arsyet se pse rritet numri i firmave që bankrotajnë brenda një viti.

"Duhet të dihet mirë se shkalla e rritjes së firmave që bankrotajnë janë për shkak të vendosjes së taksave të reja fiskale nga ana e shtetit. Nëse kjo është arsyeja e vetme, atëherë kjo nuk është dhe aq tragjike. Mirëpo nëse bankroti është shpallur për shkak të gjendjes së rëndë financiare, atëherë kemi një situatë shumë të keqe. Dy vitet e fundit kanë qenë shumë të vështira për të bërë biznes për shkak të gjitha gjërave që ndodhën gjatë 10 viteve të fundit. Patëm një ekonomi të stagnuar, e cila në mënyre direkte ndikoi në mos funksionim të rregullt të firmave. Të shpresojmë se gjatë gjysmë vjetorit të dytë të këtij viti, të kemi rezultate të mira sa i përket aktivitete punuese të firmave dhe se kjo të parandalonte që shumë firma që janë në gjendje të rëndë financiare, të mos marrin vendime për bankrot", thotë Bytyqi.

## Edhe 15 milionë euro për bujqësinë

Shkup, 2 shtator - Për vitin 2019, përmes BE-së dakorduar 15 milion euro përkrahje në bujqësinë e Maqedonisë. Me 3,5 milion euro prej tyre do të ndërtohen sisteme të reja të ujitjes, ndërsa me 4,2 milion euro fabrikë për trajtimin e mbeturinave nga kafshët e ngordhura, tha ministri i Bujqësisë, Lupço Nikolovski në takim me prodhuesit në Stajkovc dhe Creshevë. Me inkuadrin në Bashkimin Evropian (BE), theksoi Nikolovski, bujqit e Maqedonisë direkt do t'i marrin subvencionet nga BE-ja. Gjithsej 400 miliard euro janë parashikuar në buxhetin e BE-së për vitin 2014-2020 për zhvillimin e bujqësisë. "Anëtarësimi në BE dhe NATO do të thotë më shumë mjete evropiane për subvencionim, për mekanizëm, për të ardhura më të larta, prodhimtari më të mirë, dhe për plasman me çmime më të mira, bujqësi e mirëmbajtur dhe moderne, më shumë punësime në mjediset rurale dhe nxitje të rritjes ekonomike", potencon ministri. Ai përkujtoi edhe se vetëm këtë vit përmes Programit IPARD2, Komisioni Evropian i ndau Maqedonisë mbi 12 milion euro për investime në ekonomitë bujqësore, kapacitetet përpunuese, mjediset rurale, për zhvillim të bizneseve ekzistuese dhe të reja, si dhe për infrastrukturën publike rurale. Në bisedë me prodhuesit e dy fshatrave të Shkupit ku mbi-sundon kopshtaria, ai i dëgjo propozimet e tyre për përpunim të bujqësisë. Siç kumtoi Ministria e Bujqësisë, për bujqit e Maqedonisë dhe për banorët e rajoneve rurale, duke e përfshirë edhe Stajkovcin, më i rëndësishëm është inkuadrin i Maqedonisë në BE dhe NATO.

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 2 gusht - Përfundimisht me vitin 2017 kemi rritje për 3.2 për qind të firmave që kanë bankrotuar apo mbi 2500 firma kanë pushuar së funksionari gjatë vitit të kaluar. Kështu rezultoi Raporti për stabilitetin financiar në Maqedoni i Bankës Popullore të Maqedonisë për vitin 2017, sipas të cilit, krahasuar me vitin 2016, vjet shkalla e bankrotimit të firmave u rrit për 2.1 për qind

"Në vitin 2017, shkalla e firmave që kanë bankrotuar gjatë këtij viti është rritur për 3.2 për qind, ndërkaq në vitin 2016 kjo shkalle ishte 2.1 për qind. Subjektet ekonomike ekzistuese gjatë vitit 2017 shumë pak kanë pasur aktivitete punuese në tregun e Maqedonisë, gjë që ka çuar deri në rritjen e numrit të subjekteve afariste që të hapin proces falimentimi, gjegjësisht 3.2 për qind nga numri i përgjithshëm i subjekteve afariste të regjistruar në Regjistrin qendror kanë bankrotuar", thuhet në Raportin e BPM-së.

Në ndërkohë, të dhënat e

## TATIMI I FITIMIT, TEVDovski PRET RITJE PREJ 30 MILIONË EURO

Shkup, 2 shtator - Në buxhetin e Republikës së Maqedonisë ka pagesë të shkëlqyer të të ardhurave, ka likuiditet të shkëlqyer, ndërsa bëjmë presion serioz për realizimin e të ardhurave të parashikuara. Ajo që më gëzon është se kemi rritje të të ardhurat e kontributeve, që përputhet me rritjen e pagave, thotë ministri i Financave Dragan Tevdovski, në intervistë për MIA-n.

Kah fundi i muajit, siç thotë ministri, do ta shpallin edhe raportin

për muajin gusht, duke potencuar se ajo që shihet si trend në tetë muajt e parë është rritja e të ardhurave tatimore të fitimit. "Presim rritje rreth 30 milion euro te tatimi i fitimit deri në gusht. Kjo është shenjë e qartë se firmat rikuperohen dhe ekonomia mbetet në këmbë. Të dhënat e fundit për prodhimtarinë industriale në muajin gusht tregojnë rritje të lartë prej 8,4 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar", thekson Tevdovski.

Sipas të dhënave të investimeve të huaja direkte (IHD), siç sh-ton, ka rritje të lartë në krahasim me vitin e kaluar. "IHD në gjysmën e parë të vitit arriti 327 milion euro. Vetëm në krahasim me vitin 2017 për tërë vitin IHD arritën 227 milion euro. Qeveria edhe më tutje do të vazhdojë të krijojë mundësi për zhvillim ekonomik. Me kahëzimin e qartë drejt BE-dhe NATO-s, kjo gjendje edhe më shumë do të përmirësohet", thotë ministri Tevdovski në intervistë për MIA-n.



Mjekët nuk përjashtojnë faktin se pacientët duhet të marrin informacionin në libra dhe më pas të kërkojnë këshilla nga profesionistët, por jo edhe të konsumohen ilaçe të blera në internet dhe pa konsultim paraprak me mjekun

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 2 shtator - Kërkimi i vazhdueshëm për informacione në internet mbi sëmundjet ka bërë që shumë njerëz të heqin dorë nga doktori dhe me këtë, të rrezikojnë edhe shëndetin. Alarmi është ndezur me rritjen e madhe të faqeve në internet—gjoja të shëndetësisë dhe shit-bletjet online të ilaçeve, pa kontroll paraprak të institucioneve shëndetësore si dhe pa adresë të saktë të shitësit në internet.

Shumë qytetarë thonë se vizitojnë faqet e internetit për një dietë, për të trajtuar infeksione të ndryshme, për të trajtuar ekzemën, e cila është forma më e mirë e qetësisë ose për një gjumë më të mirë në orët e vona të natës. Mjekët nuk përjashtojnë faktin se pacientët duhet të marrin informacionin në libra dhe më pas të kërkojnë këshilla nga profesionistët, por jo edhe të konsumohen ilaçe pa konsultim paraprak me mjekun. Dr.Besnik Zeqiri thotë se është e pajustificueshme që i njëjti sëmuri të gjejë këshilla për sëmundjen e tij në internet, kur i njëjti ka mjekun amë dhe specialistë të shumtë në klinika dhe institucione tjera shëndetësore në vend.

"Nuk e dimë se nga vjen kjo mungesë dëshire për të vizituar mjekun dhe të marrë informacionet e duhura në rast nevojë. Megjithatë, ka dy arsye - ose informohen nga rrjetet sociale, ose edhe për shkak të pritjeve të gjata

KËSHILLA TE MJEKU DHE JONË INTERNET

## DOKTOR "GOOGLE" MË I VIZITUAR SE DOKTORI SPECIALIST!



që caktohen me të ashtuquajturën 'temini im'. Kuptohet që duan të gjejnë menjëherë 'derman' për sëmundjen e tyre. Por, nëpërmjet internetit nuk është e justifikueshme të merren këshilla", thotë mjeku Zeqiri.

Ai nuk përjashton faktin se ka forume që kontrollohen nga mjekë të mirëfilltë dhe kjo mund të praktikohet kur qytetari pyet dhe mjeku profesional përgjigjet.

"Por, në mënyrë vetjake të konsumohet ilaçi që është 'konsultuar' nga çdo faqe në internet, është e ndaluar rreptësisht, sepse pastaj nuk ka përgjegjësi mjeku në atë se çfarë ka ndërmarrë vetë pacienti. Duke dashur që pacienti ti bëjë mirë vetvetes, ai vetëm e ngadalëson procesin e trajtimit të një sëmundje ose madje e përkeqëson. Pra, është e papranueshme për mjekun që pacienti të merr udhëzime për barëra nga interneti dhe më pas të ankohet se ato barëra nuk i kanë bërë mirë", thotë Zeqiri.

Me këtë rast, mjekët apelojnë që Ministria e Shëndetësisë, por edhe institucioneve tjera përkatëse si Ministria e Shoqërisë Infor-

mative, dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, si dhe ajo e Punëve të Brendshme të bëjnë kontroll të rrjeteve sociale, me qëllim që të bllokohen faqet që tregojnë ilaçe të dyshimta dhe me këtë rrezikojnë jetën e qytetit.

Në ndihmë të qytetarëve janë ofruar edhe farmacistët, të cilët siç thonë nga Shoqata e Farmacistëve, janë personat konkret që japin përgjigje për përmbajtjen dhe rrezikshmërinë e një ilaçi, qoftë madje i blerë edhe online. "Roli i farmacistit është të komunikojë me çdo pacientë për të marrë informacion në lidhje me gjendjen e tij, trajtimin që përdor dhe cilat ilaçe ai përdor. Farmacisti mëson e pacientin se si të marrë medikamentet dhe të eliminojë dilemat që ekzistojnë tek njerëzit që përdorin informacion online", thonë nga farmacia "Val Farm" në Shkup.

Nga ana tjetër, mjekët thonë se shumë sëmundje mund të kenë simptoma të ngjashme, ndërsa vetëdiagnostikimi dhe trajtimi mund të çojë në pasoja katastrofale. Mund të ketë gjithashtu një situatë të kundërt kur një pacient,

me "ndihmën" e Google, konstaton se nuk ka sëmundje serioze dhe kështu vonon vizitën e mjekut, gjë që mund të përfundojë me pasoja serioze. Hulumtimet tregojnë se 1 në 7 njerëz në Evropë diagnostikohen në internet, dhe supozohet se numri i këtyre pacientëve është në rritje me rritjen e numrit të faqeve të internetit. Numër alarmant i qytetarëve që i drejtohen internetit për ndihmë mjekësore ka edhe në Maqedoni. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme raportojnë se shumë qytetarë janë ankuar se janë mashtruar dhe dëmtuar nga faqe të ndryshme të enterit që gjoja, ofrojnë shërbime mjekësore. "Kur një qytetar vendos t'i drejtohet internetit për blerje online, duhet pasur shumë kujdes kur japin të dhënat personale dhe llogaritë bankare, pasi i madh është numri i qytetarëve që po mashtrohen dhe po pësojnë. Ka raste kur shuma e paguar nuk korrespondon me produktin e blerë, ndërsa firma që ka bërë shitjen online, nuk është e regjistruar në asnjë institucion shtetëror në vend", thonë në MPB.

## KRONIKË

### Grabitet një "BMË" në Kala të Shkupit

Një autor i panjohur dje pasdite ka grabitur automjetin "BMË 530" në rrugën "Lazar Liçenovski" në Shkup duke fituar interes pronësor kundërligjor prej rreth 976.000 denarë. Siç informon MPB, automjeti ka qenë me targa suedeze, ndërsa në të ka pasur lap-top dhe valixhe me veshmbathje. Ngjarjen mbrëmë e ka paraqitur L.Ç. (34) sipas të cilit, grabitja ka ndodhur në periudhën mes orës 14:00 dhe 19:00. Ndërmerren masa për zbardhjen e tërësishme të rastit.

### Në Miravc kapen 14 emigrantë

Gjithsej 14 emigrantë prej të cilëve 11 afganë dhe tre pakistanezë janë gjetur dje pasdite pas vendkalimit Miravc në autostradën Gjevgjeli-Shkup. Siç kumtoi MPB, policia së pari e ka vërejtur, ndërsa pastaj edhe është nisur pas automjetit "Honda" në të cilin ishin emigrantët. Ka qarkulluar drejt Shkupit me shpejtësi të madhe, ka pasur targa të Shkupit, ndërsa me të ka qarkulluar R.F. (41) nga fshati Hasanbeg i Shkupit. Në një moment, "Honda" është ndalur, emigrantët kanë dalë nga makina, pas së cilës ka vazhduar të qarkullojë, por për një kohë të shkurtër është zënë. R.F. është privuar nga liria, ndërsa pas konsultimit me Prokurorin Publik emigrantët janë marrë për procedurë të mëtejshme.

### Kontrolluesi i autobusëve goditet 18-vjeçarin

T.B.(28) nga Shkupi të shtunën ka paraqitur se kontrolluesi i NQP-së e ka goditur me grusht derisa ka qenë në autobusin me numër 15. Siç informon MPB ngjarja ka ndodhur pasdite në rrugën "Lubanska". Sipas denoncimit, kontrolluesi i NQP-së i ka kërkuar biletë T.B. dhe prejse e ka kontrolluar, i ka kërkuar sërish të paguajë kartë T.B. ka refuzuar dhe në një moment kontrolluesi me grusht e ka goditur në pjesën e buzëve. Policia ka përgatitur procesverbal për shkeljen e konstatuar.

ZAEVI DHE CAROVSKA TREGOJNË PRIORITETET E QEVERISË

## MBROJTJE MË TË MADHE PËR PENSIONISTË

Shkup, 2 shtator - Masat për sigurim të standardit më të lartë, kujdesit dhe mbrojtjes së pensionistëve janë prioritet i Qeverisë, porositi kryeministri Zoran Zaev dhe ministrja e Punës dhe Politikës Sociale Milla Carova në hapjen e Lojërave të 23-ta sportive të pensionistëve në Radovish.

"I ndjekim praktikat evropiane, shikojmë se si jetojnë pensionistët në vendet e Bashkimit Evropian, më me komoditet dhe më me rehati dhe pikërisht për atë çdo ditë punojmë për atë edhe hapat strategjik të cilat i ndërmarim çojnë pikërisht drejt Bashkimit Evropian. Ato hapa janë për ta ngritur standardin e nivelit dinjitoz ashtu siç ngjan me secilin, i cili



me nder i ka kaluar vitet e tij produktive, dhe duhet të kënaq ditët e pensionimit me krenari", tha Zaev. Ministrja Carova potencion se me organizimin e ngjarjeve të ndryshme nga karakteri social, kulturor dhe sportiv, Lidhja e pen-

sionistëve kontribuon të përmirësohet statusi i tyre. U rekomandoi se Ministria me përkushtim punon në sigurimin e kushteve më të mira për jetë dinjitoze të atyre qytetarëve të cilët me përvojën jetësore që e kanë janë mjet

shumë i rëndësishëm në shoqëri. Në hapjen e lojërave fjalim mbajtën edhe Saltir Karovski, kryetar i BD të LSHPM dhe kryetari i SHP Rdovish dhe Konçe, Jordan Kostadinov. Të pranishmit i përshëndetën edhe kryetarët e komunave të Radovishit, dhe Konçes, Gerasim Konzulov dhe Blagoj Iliev. Lojërat i organizon Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, ndërsa janë nën udhëheqësi të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Ngjarja organizohet tradicionalisht tashmë 23 vite, me rastin e organizimit pensionist edhe në të marrin pjesë mbi 500 pensionistë nga shoqatat e pensionistëve përreth botës.







# ISIS është gati të ringrihet

Nga

Hassan HASSAN



Për gati një vit, vëzhguesit e Shtetit Islamik kishin pyetur nëse Ebu Bekr El-Bagdadi, udhëheqësi i grupit, ishte ende gjallë. Pastaj të mërkurën, ai u rishfaq për herë të parë pas 11 muajsh, duke mbajtur një fjalim të regjistruar, me rastin e festës së Kurban Bajramit. Në fjalimin 55-minutësh - më i gjati i atyre që janë bërë deri më tani publike - ai i referohej ngjarjeve të fundit, duke treguar se videoja ishte regjistruar gjatë javëve të fundit. Ky fjalim erdhi në mesin e raporteve për një ringjalljeje të ISIS në Dijala, Salah Ad-Din dhe Kirkuk në Irak, të gjitha zona që grupimi i humbi disa vjet më parë.

Në përgjithësi, grupi ka humbur rreth 98 për qind të zonave që kontrollonte dikur. Fjalimi, pasoi ndërkaq vlerësimet e habitshme si nga Pentagoni, ashtu edhe nga Kombet e Bashkuara, se grupi ende ka më shumë se 30.000 luftëtarë në Irak dhe Siri. Degët e tij në vende si Afganistani dhe Egjipti, kanë qenë dukshëm më vdekjeprurëse dhe aktive në muajt e fundit. Me fjalë të tjera ISIS-i ka pësuar në dukje një tranzicion të rregullt nga kalifati tek ringritja, pa ndonjë frakturë. Në fjalimin e tij, një Bagdad i inkurajuar rrëfeu historinë e ISIS-it, një milici e vogël brenda një rrjeti të gjerë grupesh kryengritëse, që luftonin kundër amerikanëve - për të tubuar ithtarët. Përveç lutjes në fillim të videos, fjalimi i Bagdadit, tregoi se ISIS-i është duke u riorganizuar. Në një pasazh kyç, ai bëri thirrje për sulme të aktorëve të vetmuar në vendet perëndimore, duke përfshirë bombardimet, shpërthimet e makinave dhe sulmet me armë dhe thika.

Më parë, thirrje të tilla vinin vetëm nga ish-zëdhënësi i ISIS-it; fakti që tani bëhet nga vetë kalifi, thirrja ka të ngjarë të ketë më shumë peshë. Bagdadi madje bëri me dije pritshmëritë e tij: Një sulm në Perëndim, është i barabartë me një 1 mijë të tilla në Lindjen e Mesme, një raport që kujton fushatën e terrorizmit të Britanisë së Madhe Veriut para disa dekadave nga IRA, që thoshte se një bombë në Britani ishte sa 100 të tilla në Irlandën e Veriut. ISIS, ashtu si nacionalistët e dhunshëm irlandezë përpara tij, e di se sulme të tilla do të fitojnë një vëmendje mediatike më të madhe, sesa masakrimi i 220 njerëzve nga komuniteti i Druzëve në Sirinë Jugore, apo shpërthimi i një autobombe në zemër të Bagdadit. Bagdadi pohoi gjithashtu se Amerika e Donald Trumpit, po vuan nga



një ezaurim nervor, si rezultat i luftës 2-dekadëshe kundër xhihadistëve në rajon. Ai përmendi tensionet mes Uashingtonit dhe Ankarasë, lidhur me burgosjen e pastorit amerikan Endru Brunson, sanksionet e Shteteve të Bashkuara kundër Turqisë, dhe refuzimin e qeverisë së Erdoganit për t'iu përmbajtur regjimit të sanksioneve të SHBA-së kundër Iranit.

Kjo është e gjitha që po ndodh, tha ai, ndërsa "territori i xhihadit po zgjerohet". Në fakt, ndryshe nga fjalimet e mëparshme të Bagdadit, në të cilat ai hidhte poshtë pretendimet

mbi mosfunksionimin e brendshëm të ISIS dhe humbjet e tij territoriale, këtë herë ai dukej i sigurt mbi aftësinë e grupit të tij, për t'i mbijetuar stuhisë aktuale. Për të shpjeguar se si ISIS, do të nisë së shpejti një kryengritje, Bagdadi vuri në dukje të kaluarën. Ai i bëri jehonë fjalëve ikonike të Ebu Musab Al-Zarkauit, themeluesit fillestar të grupit në vitin 2006: "Shkëndija në Irak është ndezur, dhe forca e saj do të vazhdojë të intensifikohet, derisa të djegë ushtritë kryqtare në Dabiq", qytet në veri të Sirisë, që sipas disa interpretimeve të traditës

**Bagdadi pra nuk është një kalifi pakënaqur, që ankohet për kalifatit e humbur. Ai duket se po sheh përpara, duke kërkuar të frymëzojë kopenë e tij, për të rishikuar sukseset e tyre më të mëdha, dhe për të komplotuar një kurs për lavdinë e ardhshme. Fjalimi i tij e bëri të qartë se ISIS-i, i kujton shumë mirë leksionet e dy dekadave të kaluara**




islame, do të jetë vendi i një beteje epike midis ushtrive myslimane dhe atyre të krishtera. ISIS e ka cilësuar shpesh deklaratën e Zarkauit si profetike, meqë nuk kishte shenja të debilitetit në Siri, në kohën kur ajo u bë. Në dy momente në fjalimin e tij, Bagdadi iu referua Irakut si burim i shkëndijës, dhe tha se lufta është rinovuar pas humbjes së territorit.

Bagdadi iu referua gjithashtu luftëtarëve fisnorë sunite, që ndihmuan Shtetet e Bashkuara të dëbonin Shtetin Islamik të Irakut (ISI), paraardhësin e ISIS, nga qytete sunite në vitin 2007. Megjithë numërimin e tyre, ISI nisi një fushatë të suksesshme vjetore për t'i zhdukur luftëtarët sunite, si pjesë e një strategjie, gjithashtu të arsyetuar në detaje: një plumb kundrejt pushtuesit amerikan, dhe 9 plumba kundër apostatëve. Shumica e forcave, sugjeroi ai në fjalim, duhet të përqendrohet tek armiku brenda. Bagdadi mbështeti një taktikë, të cilën ISIS-i ka zbatuar me sukses të madh herë pas here: shkatërrimin e fraksioneve sunite, përmes një kombinimi të vrasjeve dhe rekrutimit. Ai premtoi se i njëjti fat i pret rebelët sirianë.

Ai gjithashtu i bëri thirrje ushtarëve të braktisin udhëheqësit e tyre

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazelë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - nr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 2 shtator | Numri i parë i gazelës do të më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

"të pabesë", të cilët ai i akuzoi për tradhti, teksa një seri të akuzuarish arritën marrëveshje me regjimin sirian. Në një referencë tjetër ndaj fiseve sunite, Bagdadi vuri në dukje se forcat irakiane mbeten shumë të varura nga ushtria amerikane për të penguar sulmet e ISIS-it. Luftëtarët e ISIS, kanë sulmuar anëtarë të fiseve të mëdha në Irak në mes të ditës tha ai, pavarësisht apelimeve të shpeshta nga udhëheqësit fisnorë ndaj milicive Shiite, por edhe qeverisë në Bagdad për mbrojtje. Përgjatë verës, ISIS-i duket se ka vënë në shënjestër liderët e komunitetit, milicite kryesore dhe forcat e sigurisë, pa u ndëshkuar. Forcat proqeveritare janë sulmuar nga militantët, dhe bëjnë shpesh thirrje për sulmet ajrore amerikane, për të frenuar sulmet e vogla të ISIS-it. Për shembull, vetëm pak kohë më parë, rreth 20 luftëtarë morën kontrollin e një impianti të madh të naftës, në zemër të një zone të siguar nga koalicioni ndërkombëtar i udhëhequr nga SHB-ja në Deir Ezzor, dhe u neutralizuan vetëm pas sulmeve ajrore amerikane.

Bagdadi foli gjithashtu për qëllimin e grupit të tij, për të përhapur ndikimin e saj në të gjithë rajonin - një temë e përsëritur në deklaratat e ISIS, që kur filloi të humbiste terren në vitin 2016. Grupi është përpjekur të tërheqë rreth vetes sauditët, duke folur në gjuhën e islamizmit fundamentalist të pranuar atje, dhe duke e përdorur goditjen politike ndaj Sisit në Egjipt, për të joshur edhe egjiptianët. Në qershorin e vitit 2017, ISIS-i goditi brenda Teheranit, kryeqyteti i Iranit, sulmi i parë i tillë në historinë e xhihadizmit sunit. Militantët sulmuan parlamentin iranian dhe mauzoleumin e themeluesit të Iranit, Ajatollah Ruhollah Khomeini, duke vrarë 17 vetë. Kjo ishte pjesë e përpjekjes së grupit për të minuar Al-Kaidën, e cila ka shmanjur konfrontimin me Iranin, dhe për ta pozicionuar veten si mbrojtës të sunitëve, kundër të gjithë armiqve të tyre.

Bagdadi pra nuk është një kalif i pakënaqur, që ankohet për kalifatin e humbur. Ai duket se po sheh përpara, duke kërkuar të frymëzojë kopenë e tij, për të rishikuar sukseset e tyre më të mëdha, dhe për të komplotuar një kurs për lavdinë e ardhshme. Fjalimi i tij e bëri të qartë se ISIS-i, i kujton shumë mirë leksionet e dy dekadave të kaluara. Nëse edhe armiqet e tij bëjnë po kështu, dallimi qëndron mes fitores dhe humbjes. *(The Atlantic)*

Hassan Hassan, është bashkë-autor i librit "ISIS: Brenda ushtrisë së terrorit", dhe një bashkëpunëtor në Institutin Tahrir për Politikë dhe Lindjes së Mesme me seli në Uashington

# Rishikimi i kufijve të Ballkanit do të ishte një gabim fatal



Nga  
Adnan CERIMAGIC

Gjatë një aktiviteti të përbashkët me presidentët e Kosovës dhe Serbisë fundjavën që shkoi, unë i bëra një thirrje të drejtpërdrejtë të dyve, që të mos bëjnë gabimin fatal, duke e destabilizuar të gjithë rajonin e Ballkanit. Unë fola jo vetëm si analist politik, por edhe në aspektin personal si një qytetar i Ballkanit, duke rrëfyer historinë se si vendlindja ime në Bosnjë Hercegovinë u shkatërrua nga lufta, dhe rilindi sërish si një komunitet multietnik. Duke ju drejtuar presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe atij të Kosovës, Hashim Thaçi, unë paralajmërova rrezikun e përpjekjes për t'u marrë me pakicat me qëllim zhdukjen e tyre, dhe me kufijtë që reduktohen përgjatë vijave etnike.

Unë i bëra ndërkohë thirrje Bashkimit Europian, të përfaqësuar nga një komisioner evropian dhe presidentët e dy vendeve të BE-së, për t'ia bërë të qartë Thaçit dhe Vuçiqit, se nuk do ta mirëprisnin ndonjë masë të tillë. Mjerisht, druhen se ankesa ime deri më tani ka rënë në vesh të shurdhër. Në fjalimet e tyre në Forumin Evropian Alpbah, Vuçiq dhe Thaçi, e kanë bërë të qartë se janë të gatshëm të diskutojnë kufijtë, në një përpjekje për të arritur një zgjidhje të përhershme të paqes. Përfaqësuesit e BE-së, thanë se nuk do t'i dekurajonin në këtë drejtim.

Dhe kjo rrezikon të gjallërojë idenë e rrezikshme, që ushqeu për një dekadë luftën në vitet 1990: konceptin, se njerëzit janë të sigurt, vetëm në mesin e grupit të tyre etnik. Nëse kjo ide fiton besueshmëri, dhe sërish bëhet një program i mundshëm politik për nacionalistët në të gjithë rajonin, kjo do të kishte pasojat më të rënda për Ballkanin në tërësi. Nëse udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë, ndryshojnë kufijtë për t'i bërë vendet e tyre më pak multietnike, çfarë do t'i ndalonte udhëheqësit e tjerë, që të vendosin të bënin të njëjtën gjë? Kjo do të çojë në frikë, tensione dhe agresion - dhe fanatikët mund të vendosin të përdorin sërish dhunën. Këto të gjitha kanë ndodhur edhe më parë.

Duke treguar historinë e vendlindjes sime, dua të përcjell mbi të gjitha një gjë: që ringjallja e qytetit, ishte e mundur vetëm sepse bashkësia ndërkombëtare dërgoi një mesazh të qartë në fund të luftës në Bosnjë: s'ka ndryshime kufijsh përgjatë vijave etnike. Unë linda në vitin 1986, në një qytet të vogël në Bosnjën veriore, të quajtur Doboj. Isha 5 vjeç kur shpërtheu lufta në

ish-Jugosllavi dhe 6-vjeç, kur nisën luftimet në Bosnje. Bashkë me nënën dhe vëllain tim, e kalova luftën si një refugjat në Kroaci. Babai im mbeti në Bosnjë, duke u përfshirë në luftime. Isha 9, vjeç kur përfundoi lufta më 1995. Familja ime ishte me fat, sepse ne të gjithë mbijetuan. Por e mbaj mend shumë mirë kur vizituam Dobojin për herë të parë pas luftës, në shkurtin e vitit 1996. Ishte një qytet i tmerrshëm: boshnjakët dhe kroatët ishin dëbuar, minaret dhe xhamitë ishin shkatërruar, dhe shumë shtëpi ishin dëmtuar.

Ne as nuk guxim të thonim me zë të lartë në rrugë, emrat tanë boshnjakë myslimanë. Për muaj e vite pas luftës, unë kisha makthe për Dobojin.

Që atëherë, Bosnje Hercegovina ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Numri i paqeruajtësve të huaj ka rënë, nga 60.000 në vitin 1996 në vetëm nën 1.000 sot. Që nga viti 2006, ka pasur një ushtri të përbashkët, dhe rekrutimi i detyrueshëm është shfuqizuar. Unë jam pjesë e gjeneratës së boshnjakëve të rinj, që nuk janë detyruar kurrë të përdorin armë.

Por, siç u thashë liderëve të shtunën e shkuar, sot jam vërtet i brengosur. Unë jam shumë i ri për të kujtuar vitet para luftës, por tani di shumë për atë periudhë. Shumë intelektualë dhe politikanë jugosllavë folën për kufijtë, padrejtësitë dhe të drejtat etnike. Ata të gjithë përdorën një argument të thjeshtë, por destruktiv: Ju jeni të sigurt, vetëm kur dhe ku grupi juaj etnik mbizotëron.

Disa ide duken në fillim të pafajshme, por ato mund të bëhen monstruoze. Kjo ide shkatërroi Jugosllavinë dhe Dobojin. Shkatërroi familjet, çoi në dëbime masive, dhe në gjenocid në Srebrenicë. Ai ktheu kufijtë në plan të parë, dhe krijoi me gjak kufij të rinj. Por idetë mund të mposhten.

Doboj i dëshmon këtë. Sot qyteti është pjesë e Republika Srpska, një nga dy rajonet kryesore të Bosnjës dhe Hercegovinës, të njohura formalisht si "entitete". Emri i rajonit nënkupton një karakter etnik serb, dhe rreth 1 milionë serbë jetojnë atje. Por ata jetojnë së bashku me 230.000 njerëz nga grupimet e tjera etnike. Në Doboj, gjysma e popullatës jo-serbe të para luftës është rikthyer - pothuajse 20.000 prej tyre. Xhamitë janë rindërtuar, nga minaret mund të dëgjohen thirrjet për lutje, ndërsa kremtohen festat katolike dhe myslimane.

Doboj i anktheve të mia, është

**Detyra e brezit tonë, nuk është që të negociojmë mbi kufij, por t'i bëjmë ata të parëndësishëm - t'i kthejmë kufijtë e Ballkanit në evropianë, si ato midis Tirolit dhe Tirolit të Jugut, ose midis Gjermanisë dhe Polonisë. Dhe për ta bërë këtë, ne kemi shumë punë përpara: të ndërtojmë institucione të bazuara në sundimin e ligjit, të forcojmë demokracitë tona, të nxisim lirinë e medias dhe shumë më tepër**



sot një qytet i zakonshëm, ku boshnjakët dhe kroatët, nuk kanë frikë nga kryebashkiaku i tij serb. Ata votojnë vazhdimisht për të - edhe kur një kandidat boshnjak garoi për këtë post në vitin 2012. Dhe së bashku me fqinjët e tyre serbë, ata përballen me sfida të përbashkëta: shërbime të dobëta shëndetësore dhe arsimore, vende të pakta pune për të konkurruar. Doboj i sotëm, nuk do të ekzistonte, nëse nacionalistët që donin ta përdorin luftën për të ndërtuar shtete monoetnike, do të kishin triumfuar. Shumë njerëz, ndajnë mendimin tim. Të rinjtë nga i gjithë Ballkani, të cilët ishin të pranishëm për diskutimin e së shtunës, i pritën me entuziazëm vërejtjet e mia. Ambasadorët e BE dhe diplomatët e lartë nga i gjithë rajoni, më dërguan një e-mail inkurajues. Ka pakica në mbarë rajonin, ta cilët mbështeten në angazhimin se s'ka nevojë të jenë shumicë, për të pasur një të ardhme të mirë.

Megjithatë, kërret e Kosovës dhe të Serbisë, u përpoqën të na bindnin se ideja që e shkatërroi Jugosllavinë dhe e shtyu Ballkanin Perëndimor në periferi të Europës, do të ndihmonte tanimë që të dyja vendet, dhe që rajoni t'i afrohet BE-së. Unë u thashë atyre se, përkundrazi, rilindja e kësaj ideje do ta rrezikonte përparimin e dy dekadave të fundit.

Detyra e brezit tonë, nuk është që të negociojmë mbi kufij, por t'i bëjmë ata të parëndësishëm - t'i kthejmë kufijtë e Ballkanit në kufijtë evropianë, si ato midis Tirolit dhe Tirolit të Jugut, ose midis Gjermanisë dhe Polonisë. Dhe për ta bërë këtë, ne kemi shumë punë përpara: të ndërtojmë institucione të bazuara në sundimin e ligjit, të forcojmë demokracitë tona, të nxisim lirinë e medias dhe shumë më tepër. Këto janë sfidat, mbi të cilat duhet të përqendrohen udhëheqësit politikë, dhe jo të ndryshojnë territore në një hartë.

Disa anëtarë të panelit e cilësuan diskutimin tim si "historik". Unë jam shumë i ri dhe plot shpresë për ta parë veten si një Kasandër, ndaj shpresoj që ata ta kenë gabim. Sepse, nëse idetë e prezantuar në Austri bëhen realitet, ky diskutim do të mbahet mend për arsyet e gabuara.

Ai do të hynte në histori si një kthesë tragjike, drejt një destabiliteti të shmangshëm. *(Politico.eu)*

Adnan Cerimagic, është analist i institutit evropian të Nismës së Stabilitetit, me seli në Berlin



# BRUKSELI, QYTETI I SPIUNËVE

“Lufta e Ftohtë është kthyer”, thekson një ish-zyrtar i lartë i inteligjencës belge, duke shtuar se tani ka më shumë agjentë që veprojnë në Bruksel, sesa në vitet para shembjes së Murit të Berlinit. “Kinezët, rusët, amerikanët dhe marokenet, kanë një prani të madhe në Belgjikë”, shton ish-zyrtari, duke folur me kushte anonimiteti. Diplomatët në Bruksel supozojnë se po monitorohen çdo ditë

Nga Lili BAJER

Harrojeni Vjenën dhe Berlinin. Ekziston një tjetër fole e madhe spiunësh në Europë: Brukseli. Dyshimet midis zyrtarëve të BE-së, se Britania e Madhe i spiunoi ata për t'i vjedhur planet e mbi Brexit, bënë bujë në mediat britanike javën e shkuar. Por për shumë njerëz në Bruksel, spiunimi si i miqve ashtu edhe armiqve, është thjesht një biznes i zakonshëm.

Për disa agjenci të huaja të inteligjencës, Brukseli është një objektivi, pasi aty ndodhet selia e Bashkimit Europian dhe NATO-s. Për të tjerët, si disa shërbime inteligjence afrikane dhe të Lindjes së Mesme, fokusi është mbi diasporat e tyre të mëdha që banojnë në Belgjikë, të cilat ndikojnë në politikën kombëtare. Në qershor, kreu i agjencisë së inteligjencës Austrisë, Peter Gridling, u tha gazetarëve se “Brukseli tani e ka tejkaluar Vjenën”, kur është fjala për dendësinë e “të ashtuquajturave shërbime të inteligjencës jashtë BE-së”. Ndërsa spiunimi ka qenë gjithmonë i pranishëm në Bruksel, tekta rëndësia e BE-së u rrit së bashku me numrin e ambasadave në qytet, po kështu ndodhi edhe me numrin e spiunëve.

“Lufta e Ftohtë është kthyer”, thekson një ish-zyrtar i lartë i inteligjencës belge, duke shtuar se tani ka më shumë agjentë që veprojnë në Bruksel, sesa në vitet para shembjes së Murit të Berlinit. “Kinezët, rusët, amerikanët dhe marokenet, kanë një prani të madhe në Belgjikë”, shton ish-zyrtari, duke folur me kushte anonimiteti. Dhe duke zbuluar se Shërbimi Belg i Sigurisë, u ka kërkuar disa agjentëve të huaj të largohen nga vendi gjatë viteve të fundit. Diplomatët në Bruksel, supozojnë se po monitorohen çdo ditë.

“Ka pasur një shqetësim mbi një

aktivitet të inteligjencës së huaj”, tha Haurd Gutman, ish ambasador i SHBA-së në Belgjikë. Zyra e ambasadorit kontrollohej rregullisht për pajisjet e përgjimit, dhe asnjë telefon nuk lejohet brenda në godinë, tha Gutman. Por jashtë, u kuptua se të tjerët po na përgjonin. “Ka kaq shumë njerëz brenda dhe jashtë, sa që s’ka asnjë mënyrë për ta parandaluar atë, ju duhet vetëm të supozoni në çdo kohë, që rusët dhe kinezët po ju përgjojnë”, thotë Gutman.

Ceremonitë e festave kombëtare, kur diplomatët vizitojnë ambasadat në pritjet e dhëna me këtë rast, janë raste të arta për veprimtarinë e inteligjencës, tha Gutman, duke vënë në dukje se atashetë që shoqërojnë ambasadorët në raste të tilla, janë shpesh oficerë të fshehtë të inteligjencës. “Për shkak të BE-së dhe NATO-s, vendet e tjera kanë një mision thelbësor diplomatik dhe ekonomik në Bruksel, duke krijuar një ambient të pasur për qëllime të të gjitha llojeve të spiunazhit” - tha një ish-zyrtar i lartë i inteligjencës amerikane, i cili nuk pranoi të identifikohet me emër. “Brukseli është gjithashtu një qytet lehtësisht i depërtueshëm, për të hyrë brenda dhe dalë jashtë, gjë që mund të lehtësojë operacione të

ndjeshme”, shtoi ky ish-zyrtar. Vetë Shtetet e Bashkuara, janë larg nga të qenit një palë e pafajshme në skenën e spiunazhit në Bruksel. Në vitin 2013, “Der Spiegel” raportoi se sipas dokumenteve të dhëna nga informatori Eduard Snouden, SHBA-të kishin kryer një operacion elektronik përgjimi ndaj institucioneve të BE-së në Bruksel - dhe gjithashtu përgjonin misionet diplomatike të BE-së në Uashington dhe Kombet e Bashkuara.

Dy vjet më vonë, revista gjermane raportoi se shërbimet amerikane të inteligjencës kishin tentuar të përdornin objektet gjermane për të spiunuar qeverinë, kompani dhe institucione të tjera, duke përfshirë edhe Komisionin Europian. Komisioni Europian, Këshilli Europian, Parlamenti Europian dhe NATO, kanë secila zyrat e tyre të sigurisë, që punojnë në parandalimin e spiunëve nga depërtimi në godinat e tyre, dhe qasja në dokumente të rëndësishme të veçantë. Në vitin 2003, pajisjet e përgjimit u zbuluan në ndërtesën Justus Lipsius të Këshillit Europian, me një hetim zyrtar belg që më vonë tregoi gishtin e dyshimit mbi qeverinë izraelite.

Zyrtarët e sigurisë, përpqen



gjithashtu të paralajmërojnë stafin të ketë kujdes, kur flet për punën në kafenet dhe restorantet e qytetit. “Ne e dimë se ka fuqi të jashtme, jashtë BE-së, që përpqen të hyjnë në të dhënat tona” - tha një zyrtar i lartë i sigurisë së BE. “Këshilla jonë e përgjithshme, është që të jemi të kujdesshëm dhe të vëmendshëm në hapësirat publike”. Ndërsa institucionet ndërkombëtare, përpqen të kontrollojnë atë që ndodh brenda ndërtesave të tyre, barra më e madhe e punës së kundërzbulimit në qytet bie mbi Shërbimin Belg të Sigurisë Shtetërore. “Çdo shërbim ka njerëzit e vet këtu” - tha ish-zyrtari i lartë i inteligjencës belge, duke shtuar se aktiviteti i spiunazhit në Bruksel, mbulon fushat nga energjia tek mbrojtja, dhe çështjet politike si emigracioni.

“Kemi shërbime miqësore, neutrale dhe jo miqësore”, tha ky person, duke vënë në dukje se agjentët e inteligjencës në përgjithësi punojnë si diplomatë të fshehtë, dhe

shpesh deklarohen para Shërbimit të Sigurisë Shtetërore pas mbërritjes në Bruksel. Në një vend të njohur për shtresa të shumta dhe të mbivendosura të qeverisë, koordinimi midis institucioneve të sigurisë belge dhe të BE, lë ndonjëherë shumë për të dëshiruar, thonë ekspertët. “Kur ka kaq shumë pengesa në ndarjen e informacionit, dhe përgjegjësia e hetimit është vazhdimisht një ping-pong mes institucioneve, si mund të prisni të kapni fajtorin dhe të angazhoheni në veprime të mira?”, thotë Kenet Lazoën, ekspert mbi inteligjencën belge në Universitetin e Gentit.

Autoritetet belge ndodhen gjithashtu nën presion nga sfidat me të cilat ballafaqohen, veçanërisht pasi Brukseli u bë një objektivi i terrorizmit të radikalëve islamike. Shërbimi i Sigurisë Shtetërore, me një staf prej qindra vetash, ka një mandat që përfshin ruajtjen e të dhënave mbi terrorizmin, spiunazhin, përhapjen e armëve dhe krimin e organizuar. “Çdo shërbim, është për momentin i fokusuar tek terrorizmi”, tha ish-zyrtari i lartë i inteligjencës belge. “Ne kemi një problem me personelin, me mjetet, me burimet”, tha ky person, duke shtuar se numri i njerëzve në shërbim, duhet të paktën të dyfishohet.

“Fokusi mbi terrorizmin, nuk do të thotë se duhet të humbni fokusin ndaj spiunazhit kibernetik dhe klasik” - tha ish-zyrtari. “Kur nuk investoni në gjetjen e burimeve, humbni pozicionin tuaj të inteligjencës, të cilën është e vështirë ta rifitoni”.

(Politico.eu)



# ITALINË E SHPËTON TURIZMI MARTESOR



Rajonet më të njohura janë Toskana (31.9% e ceremonive), Lombardia (15%), Campania (14%), Veneto (8%) dhe Lazio (7%). Puglia ka pritur gjithashtu bumin e fundit, ndërkohë që aksionet e mbetura janë të shpërndara në të gjithë vendin. Çdo vit, në Itali, turizmi martesor numëron mbi 1 milion të huaj të pranishëm dhe më shumë se 7 mijë ceremoni martesore

Ndërsa italianët mendojnë gjithnjë e më pak për altarin, mijëra çifte të huaja ëndërojnë të thonë premtimet e tyre në Itali. Ka amerikanë që martohen në Salento, të frymëzuar nga seritë televizive 'The Bold and The Beautiful'. Qindra çifte kineze duan të martohen në Romë, si dhe shumë më tepër në Vicenza në rezidencat verore të Monteçhi dhe Capuleti. Turizmi i dasmës në Itali po lulëzon.

Turizmi martesor është një fenomen që ka pasuruar tregun italian me rreth 385 milionë euro në vitin 2017. Ndërkohë, me hyrjen e çifteve të huaja, pritet të rritet me 7% në vitin 2018. Gjatë shtatë viteve të fundit tregu është bërë ambicioz dhe fitimprurës. Në përgjithësi, turizmi martesor kushton rreth 55 mijë euro për ceremoni. Tregjet kryesore për turizmin martesor në Itali janë Britania e Madhe (26.4%), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (20.7%), Australia (8.4%), Irlanda (5.4%) dhe Gjermania (4.9%). Shumë të huaj pri-

ren të kërkojnë martesë jo tradicionale dhe për të kënaqur nevojat e tyre nevojiten planifikues të specializuar të dasmës. Ka shumë detaje dhe njerëz në pozicione të ndryshme që nga përzgjedhësi i restorantit, fotografi, luleshitësi e deri tek ata të cilët dekorojnë tortën e dasmës. Ka një larmi të madhe kërkesash nga bashkëshortët. Disa duan dasma të shpejta dhe thjesht simbolike dhe nuk shpenzojnë më shumë se 1200 euro. Ata që e duan më shumë se kushdo tjetër këtë formulë janë zviceranët, austriakët dhe gjermanët, si dhe një pjesë e italianëve të kthyer, të rritur jashtë vendit.

Planifikuesit e dasmave dhe operatorët turistikë janë dy profesione referimi. Por ka edhe një pozicion tjetër të rëndësishëm, bashkërenduesi i planit të dasmës, udhëzuesi turistik i cili ndihmon bashkëshortët dhe të dashurit e tyre. Operatorët e turizmit të dasmës duhet të kenë shumë përvojë praktike. Ata duhet të dinë desti-

nacionet, hotelet, dyqanet për veshjet e dasmës dhe shumë më tepër.

Rajonet më të njohura janë Toskana (31.9% e ceremonive), Lombardia (15%), Campania (14%), Veneto (8%) dhe Lazio (7%). Puglia ka pritur gjithashtu bumin e fundit, ndërkohë që aksionet e mbetura janë të shpërndara në të gjithë vendin. Çdo vit, në Itali, turizmi martesor numëron mbi 1 milion të huaj të pranishëm dhe më shumë se 7 mijë ceremoni martesore. Sa i takon vendeve të preferuara për ceremoninë, renditen hotelet luksoze, vilat e njohura, restorantet, fermat dhe kështjellat. Ndërkohë, vihet re një prirej e çifteve indiane që shpenzojnë miliona për një martesë në Itali, në stilin Bollywoodian. Po ashtu, një 'valë' është regjistruar edhe nga Kina, ku rreth 60% e çifteve kineze duan të martohen jashtë vendit, sipas ekspertëve. Kinëzët e duan historinë, artin dhe romancën italiane. Ata gjithashtu e duan peizazhin dhe preferojnë

kryesisht veriun e Italisë. Nga ana tjetër, traditat italiane janë shumë të ndryshme. Italianët zgjedhin destinacione pothuajse gjithmonë një hap larg shtëpisë së tyre. Sidoqoftë, turizmi martesor ka filluar të prekë edhe banorët e metropoleve italiane. Edhe pse ende një përqindje e vogël, pritet të rritet në të ardhmen. Italianët pëlqejnë kryesisht të martohen në Gadishullin Iberik, por edhe në Afrikën e Jugut, Tajlandë dhe sigurisht në Las Vegas.

Ata që qëndrojnë në Itali nuk lëvizin nga qyteti i tyre dhe kanë tendencë të jenë tradicionalë në përzgjedhjen e vendeve. Dasmat në vila përbëjnë 68% të kërkesave. Por ka disa tendenca kurioze: serat, papafingot, depot dhe objekte si kinematë e mëparshme, fabrikat etj. Ky trend mund të prishë modelin e hoteleve (ende 18% të kërkesës), restorantet luksoze (11%), fermat dhe vendbanimet t (7%) dhe kështjellat (4%) në të ardhmen e turizmit martesor.



## Nuk je 18-vjeç, s'ka pije energji

Qeveria britanike pritet të kufizojë përdorimin e pijeve energji, për shkak të ndikimit të tyre në obezitetin e të miturve. Kryeministria Theresa May u shpreh se qeveria ka parashikuar disa strategji për të shmangur obezitetin tek fëmijët dhe se ishte tejet e domosdoshme të reduktohej konsumi i pijeve energji. Arsyja kryesore për ndalimin e shitjes së tyre është niveli i lartë i kafeinës në pijet energji, që lidhet me një seri problemesh, duke përfshirë dhimbjet e kokës dhe të stomakut, sikurse edhe hiperaktiviteti apo pagjumësia. Pijet energji kanë gjithashtu nivel më të lartë sheqeri sesa pijet e ashtuquajtura të lehta (me apo pa gaz). Sipas shifrave të publikuara nga qeveria britanike, pijet energji me sheqer kanë 60 për qind më shumë kalori dhe 65% më shumë sheqer sesa pijet normale, ndërkohë që sheqeri është një nga shkaktarët kryesorë të obezitetit. Studiuesit britanikë shprehën se shumë fëmijë po i përdorin ato për të zëvendësuar vaktin e mëngjesit. Mësuesit ankohen gjithnjë e më shumë sesi orët mësimore ndërpriten për shkak se fëmijët konsumojnë gjatë mësimin. Dy të tretat e fëmijëve të grupmoshave 10-17 vjeç dhe rreth 25% e atyre nga 6-9 vjeç konsumojnë pije energji. Rritja e këtyre shifrave vjen edhe për shkak se marka si "Red Bull", "Relentless", "Monster Energy" dhe "Rockstar" janë bërë tejet popullore.

## I NXEHTI PO RRIJT URINË E PARAZITËVE, PO RREZIKOHET PRODHIMI BUJQËSOR

Temperatura e planetit rrezikon të dëmtojë ndjeshëm prodhimin bujqësor dhe të ulë prodhimin e kulturave themeltare si gruri, orizi dhe misri

Në fakt, rritja e temperaturave botërore po i bën parazitët gjithnjë e më të uritur dhe të shumtë në numër, sa që përllogaritet një humbje në nivel botëror të të korrurave me 25% për çdo gradë më shumë të ngrohjes globale të sipërfaqes, mbi të gjitha në zonat me klimë të butë. Ky parashikim është bërë nga studiuesit e Universitetit të Uashingtonit, të drejtuar nga Curtis Deutsch që në



revistën "Science" ka publikuar një model të kultivimeve, ku janë marrë parasysh përgjigja biologjike ndaj klimës që kanë lloje të ndryshme insektesh, përfshirë

edhe parazitët, duke marrë parasysh skenarë të ndryshëm të ngrohjes.

Në këtë mënyrë është përllogaritur se humbjet botërore të

korrijeve për kulturat kryesore do të rriten me 10 deri në 25% për çdo gradë të ngrohjes globale të sipërfaqes, ku më shumë do të preken zonat bujqësore me prodhimin

më të lartë në planet, si SHBA-ja, Franca dhe Kina. Me një rritje prej vetëm dy gradësh të temperaturës së sipërfaqes së tokës vlerësohet një humbje mesatare, për shkak të insekteve, prej 31% për korret e misrit, 19% për orizin dhe 46% për grurin, e barasvlerëshme me 213 milionë tonelata.

"Kur temperaturat rriten, rritet edhe metabolizmi i insekteve, që duhet të hanë më shumë. Për më tepër, me përjashtim të tropikut, temperaturat e larta rrisin edhe nivelin e tyre të riprodhimit. Pra do të ketë më shumë insekte, që do të hanë më shumë", shpjegon Deutsch.



## NUK KA KOHË PËR KTHIM PRAPA, MARRËVESHJA E DOMOSDOSHME

“Nuk mund të kthehemi prapa, sepse historia e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është një histori tragjike. Nuk mund të qëndrojmë në vend apo të vendnumërojmë dhe as nuk kemi se çfarë të presim, sepse ngecja dhe pritja në zgjidhjen e raporteve në mes Kosovës dhe Serbisë është pikërisht thirrje për tensione, për destabilizim...”, ka thënë Thaçi

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i është adresuar ambasadorëve ndërkombëtarë në Kosovë, në lidhje me perspektivën e marrëveshjes mes Kosovës dhe Serbisë. Thaçi ka theksuar se është koha për arritjen e një marrëveshje historike në mes të dyja vendeve dhe se nuk ka kohë për kthim prapa.

“Nuk mund të kthehemi prapa, sepse historia e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është një histori tragjike. Nuk mund të qëndrojmë në vend apo të vendnumërojmë dhe as nuk kemi se çfarë të presim, sepse ngecja dhe pritja në zgjidhjen e raporteve në mes Kosovës dhe Serbisë është pikërisht thirrje për tensione, për destabilizim, për probleme të mëdha, jo vetëm në mes nesh, por edhe në mbarë rajonin. Kosova si shtet, si politikë, si shoqëri, është lodhur nga ngecja në procesin e konsoli-

### KURTI BËN THIRRJE PËR MOBILIZIM, DO KETË PROTESTA

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, duke komentuar korrigjimin e kufirit, u ka bërë thirrje anëtarëve të saj që të mobilizohen pasi në ditët dhe javët e ardhshme do të vendosen në krye të protestave qytetare dhe paqësore për ta ndaluar krimin që po i bëhet Kosovës dhe popullit tonë. “Një udhëheqësi e kapur dhe e kriminalizuar, e udhëhequr nga Thaçi, po e nxjerr në shitje territorin


e Kosovës për të fituar paprekshmërinë individuale. Ne këtë nuk duhet dhe nuk do ta lejojmë këtë pasi e kemi obligim historik dhe moral. Situata politike është ajo që ka nevojë për forcim të organizatës në ditët dhe javët e ardhshme do të vendosemi në krye të protestave qytetare dhe paqësore për ta ndaluar këtë krim që po bëhet ndaj Kosovës dhe popullit tonë”, ka thënë ai.

dimit të brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Qoftë për shkak se Serbia interferon në punët e shtetit të Kosovës, qoftë për shkak se BE-ja nuk arriti ta krijojë konsensusin për ta njohur shtetin e Kosovës apo sepse shumëkush ka menduar që me kalimin e kohës, vetvetiu, gjërat në Kosovë dhe rreth Kosovës do të zgjidhen. Doli që ky mendim ishte krejtësisht i gabuar”, ka thënë Thaçi.

Thaçi shtoi se kjo marrëveshje

do t'i hapte Kosovës rrugën e integritetit në BE dhe NATO, si dhe anëtarësimin në Kombet e Bashkuara. Në adresim, presidenti ka ritheksuar çështjen e korrigjimit të kufijve, duke thënë se koha e luftërave dhe konflikteve mes të dyja vendeve ka kaluar. Më tutje, ai tha se marrëveshja nuk do të ketë pasoja në karakterin shumëetnik të vendit dhe se Kosova do të ruaj trashëgiminë kulturore serbe që lidhet me pozitën e Kishës

Ortodokse Serbe në vend. Presidenti Thaçi ka vazhduar të mbështesë idenë e proklamuar që marrëveshja paqësore me Serbinë të përfshijë edhe korrigjimin e kufirit. Ai ka deklaruar se marrëveshja nuk do të përfshijë “ndarje dhe as shkëmbim të territorit me Serbinë”, por sipas tij, mund të bëhet një korrigjim duke përfshirë brenda territorit të Kosovës komunat Preshevë, Bujanoc e Medvegjë.



### Kouchner e quan ide të mirë korrigjimin e kufijve

Ish-përfaqësuesi i OKB-së në Kosovë, Bernard Kouchner ka komentuar debatin e fundit për rishikimin e mundshëm të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë. Ai thotë se do të ishte ide e mirë nëse pajtohen të dyja palët, por sipas tij, ky opsion ka qenë i përmendur edhe më herët. “Ka qenë opsion edhe më herët dhe mund të jetë edhe tani nëse pajtohen të dy palët. Ne mund të themi nëse është plan i mirë ose i keq, por kjo është një ide që tashmë ekziston. Kjo marrëveshje mund të jetë përfundim i luftës. Unë mendoj se është ide e mirë, edhe për Serbinë nëse ajo dëshiron që të bashkohet në BE. Dhe si pjesë e BE-së për Serbinë do të jetë e pamundur që të nxisë luftë të re”, ka thënë Kouchner, transmeton Shqiptarja. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq u angazhua pak kohë më parë për ndarje ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, duke u bërë jehonë kërkesave të Serbisë për ndarjen tokësore të Kosovës në kuadër të procesit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet të dy vendeve. Kosova e ka hedhur poshtë idenë e ndarjes tokësore të saj, ndërsa është përfshirë në debatet e nxitura nga ideja e presidentit të saj Hashim Thaçi për “korrigjimin e kufirit” që sipas tij, nënkupton bashkimin e luginës së Preshevës, një rajon me shumicë shqiptare në jug të Serbisë, me Kosovën. SHBA dhe BE nuk e kanë kundërshtuar idenë, por kanë kërkuar mos cenonte stabilitetin e Ballkanit, ndërsa Gjermania dhe Britania janë pozicionuar kundër. Përsa i përket Shqipërisë, Rama mbështeti qëndrimin e BE, ndërsa Presidenti Meta doli kundër rishikimit të kufijve.

## ÇDO MARRËVESHJE DUHET TË ÇOJË DREJT PAQES NË BALLKAN

Ndër temat e diskutuara nga kryeministrja serbe dhe Komisar Hahn ishin Kosova, eurointegrimi dhe stabiliteti rajonal



Kryeministrja e Serbisë, Ana Brnabić u takua me Komisarin për Zgjerim të Bashkimit Evropian, Johannes Hahn me të cilin bisedoi lidhur me integrimet e Serbisë, dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës dhe sundimin e ligjit. Komisar Hahn pas takimit në Ilogarinë e tij në Twitter, tha se biseda me kryeministren Brnabić në Beograd ishte e mirë dhe se ndër të tjera ata diskutuan mbi masat mbrojtëse për çelikun në Bashki-

min Evropian.

Ai tha se një grup pune punon lidhur me strategjinë mediatike. Në një njoftim të qeverisë serbe thuhet se kryeministrja dhe komisar diskutuan mbi domosdoshmërinë e ruajtjes së stabilitetit rajonal dhe se fqinjët çështjet bilaterale duhet t'i zgjidhin me dialog por gjithashtu është e nevojshme

përmirësimi i bashkëpunimit ekonomik si bazë për përparimin e të gjitha vendeve në rajon. Më tej në njoftim thuhet se Komisar Hahn, kur është fjala për negociatat me Prishtinën, tha se çdo marrëveshje duhet të sjellë paqe dhe stabilitet në Ballkanin Perëndimor, ndërsa kryeministrja Brnabić shprehu gatishmërinë e Beogradit për të

vazhduar dialogun, por theksoi nevojën për formimin e Bashkësisë së komunave serbe.

Brnabić falënderoi komisar Hahn për ndihmën dhe shtoi se Ministria për Integritet Evropian ka zhvilluar një sondazh, sipas të cilit 55 për qind e qytetarëve të Serbisë mbështesin anëtarësimin e vendit në BE.

Merkel shtoi gjithashtu se rrugët e Gjermanisë nuk janë shtruar me flori, ndërsa i këshilloi emigrantët të mësonin të qëndronin në vendet e tyre

# RRINI NË VENDET TUAJA, RRUGËT E GJERMANISË NUK JANË ME FLORI!

Presidenti i Nigerisë, Muhammad Buhari e priti kancelaren gjermane, Angela Merkel, në vilën presidenciale, Abuja. Merkel po përfundon turneun e saj në tre vende të Afrikës Perëndimore. Kancelarja gjermane në vilën presidenciale, u prezantua me disa nga anëtarët e kabinetit dhe ndihmësit presidencial, para se të mbanin në takim me dyer të mbylura për të diskutuar mbi çështje me interes të dyanshëm si për Nigerinë ashtu edhe për Gjermaninë. Ndërkohë çështja e migracionit mbetet fokus për Merkelin. Presidenti i Nigerisë, Muhammadu Buhari deklaroi se ai kurrë nuk do të mbështesë asnjë paligjshmëri lidhur me çështjen. Ai tha se ishte kundër idesë që burra dhe gra largohen ilegalisht jashtë Nigerisë në kërkim të "kullotave më të gjelbra".

"Administrata nuk i mbështet ata që shkojnë në Evropë, sepse sfidojnë shkretëtirën Sahara dhe Me-



sdheun, sepse mendojnë se ka kullota më të gjelbërta atje. Duhet të rikujtojmë se rreth gjashtë javë më parë, ne riatdhesonim rreth 3,000 nigerianë të cilët kishin mbetur në Libi në përpjekje drejt Evropës dhe gjithashtu duhet t'a keni mësuar dhe parë në televizion, numrin e madh të nigerianëve të humbur në Mesdhe", u shpreh ai. Duke folur nëpërmjet një përkthyesi gjatë

konferencës së përbashkët për shtyp, Merkel dha detaje për bashkëpunimin bujqësor dhe ndihmën tjetër që po vinte në Nigeri.

Ajo gjithashtu tha se Gjermania do të ofrojë ndihmë arsimore që të rriste numrin e studentëve nigerianë që studiojnë në Gjermani. Kancelarja e shqyrtoi nevojën e Nigerisë për të përmirësuar

## DYFISHOHET NUMRI I KËRKESAVE PËR VIZA PUNE GJERMANE NGA BALLKANI

Gjermania përballet me dyfishim të kërkesave për viza pune nga vendet ballkanike, ndërsa diplomatët e tyre në rajon më nuk janë në gjendje t'i përpunojnë të gjitha kërkesat, shkruan "Shpigel". Ambasadat e Gjermanisë në Maqedoni, Shqipëri, BeH, Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi kanë marrë madje 52.000 kërkesa të tilla në gjysmën e parë të vitit 2018, që është dy herë më shumë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2015. Më së shumti viza pune jepen në sektorin e ndërtimitarisë, hotelierisë, kujdesit për pleqtë dhe personat e sëmurë. "Numri i kërkesave të pranuar i tejkalon kapacitetet e përfaqësive tona konsullare, që solli deri në ankesa të shumta nga ana e përfaqësuesve të shoqërive ekonomike, politike dhe qytetare, shkruan në internet dokumentin e Ministrisë gjermane të cilën e publikoi "Shpigel".

gjendjen e ekonomisë, duke theksuar se migrantët duhet të ndërgjegjësohen për migracionin e paligjshëm në Evropë.

Merkel shtoi gjithashtu se rrugët e Gjermanisë nuk janë shtruar me flori. Ajo i këshilloi emigrantët të mësonin të qëndronin në vendet e tyre. "Duhet të për-

mirësohet situata në shtëpi dhe t'iu tregohet të rinjve se sa e rrezikshme është të largohen nga vendet e tyre. Shumë tregime për Gjermaninë nuk janë të vërteta", u shpreh kancelarja. Në fund të ditës të dy vendet nënshkruan tre memorandume mirëkuptimi për bujqësinë, tregtinë dhe makinat.

## 73 vjet nga fundi i Luftës së Dytë Botërore



Dy shtatori i vitit 1945, konsiderohet si fundi i Luftës së Dytë Botërore pas dorëzimit të trupave japoneze më 15 gusht të po atij viti. Më 2 shtator 1945, gjenerali i Ushtrisë amerikane, Douglas MacArthur, kryesoi një ceremoni me rastin e dorëzimit të Japonisë, çka i jepte fund Luftës së Dytë Botërore. Ceremonia e shkurtër u zhvillua në Gjirin e Tokios, në luftanijen amerikane, Missouri, anija e komandantit të flotës amerikane të

Paqësorisë. Duke iu drejtuar përfaqësuesve të aleatëve, që ishin mbledhur në anije, gjenerali MacArthur tha se sikurse mbarë njerëzimi, ai shpresonte që pas kësaj ngjarjeje kaq të rëndësishme një botë më e mirë do të dilte nga gjaku dhe tmerret e së kaluarës, një botë që do t'i përkushtohej dinjitetit të njeriut dhe plotësimin të dëshirave më të shtrenjta të njerëzimit, lirisë, tolerancës dhe drejtësisë.



## Gati gjysma e amerikanëve kërkojnë shkarkimin e Trumpit

Gati dy muaj larg zgjedhjeve të mesmandatit, Donald Trump ka rënë në nivelin më të ulët të pëlqimit gjatë presidencës së tij, me rreth 60% të personave që nuk janë dakord me performancën e tij si president. Vetëm 36% e personave të pyetur mbështetnin manjatin, sipas një sondazhi të zhvilluar nga ABC dhe "Washington Post", i publikuar dje. Megjithatë ky sondazh është realizuar mes datave 26 dhe 29 gushtit, një javë pas dënimit të Paul Manafort, ish-shëfi i fushatës elektorale të Trumpit dhe të Michael Cohenit, ish-avokati i tij personal. Në fund, 49% e të anketuarve mendojnë se Kongresi duhet të fillojë procedurën e shkarkimit të Trump, ndërsa 46% janë kundër.

## Vetëm në gusht, 391 civilë sirian të vrarë

Rrjeti Sirian për të Drejtat e Njeriut (SNHR) ka njoftuar se muajin e kaluar në Siri janë vrarë 391 civilë, shumica prej tyre nga regjimi i Bashar al Asadit



Rrjeti Sirian për të Drejtat e Njeriut (SNHR) ka njoftuar se muajin e kaluar në Siri janë vrarë 391 civilë, shumica prej tyre nga regjimi i Bashar al Asadit.

SNHR në raportin e saj bën të ditur se gjatë muajit gusht në Siri janë vrarë 391 civilë, prej tyre 66 fëmijë dhe 37 gra. Në raportin e rrjetit

thuhet se regjimi i Asadit muajin e kaluar ka masakruar 239 civilë, prej tyre 13 fëmijë dhe 8 gra.

Në sulmet e forcave ruse, të cilat ofrojnë mbështetje ajrore për regjimin, muajin e kaluar kanë humbur jetën 36 civilë, prej tyre 20 fëmijë dhe 7 gra. Ndërsa organizata terroriste YPG/PKK ka vrarë 15 civilë, prej

tyre 3 fëmijë dhe 3 gra. Në raport thuhet se organizata terroriste DEA-SH ka vrarë 12 civilë, prej tyre 5 fëmijë dhe një grua, ndërsa opozitarët ushtarakë kanë vrarë një grua. Ndërkaq palët e paidentifikuara kanë vrarë 88 civilë, prej tyre 25 fëmijë dhe 17 gra. SNHR thotë se në periudhën janar-gusht të këtij viti janë vrarë 6.036

civilë, në mesin e të cilëve ndodhen edhe gra dhe fëmijë. Në janar janë vrarë 774 civilë, në shkurt 389, në mars 1.241, në prill 408, në maj 354, në qershor 593, në korrik 886 ndërsa në gusht 391 civilë. Në raport bëhet thirrje për mbrojtjen e civilëve si dhe për gjykimin e përgjegjësve të këtyre vrasjeve.

Në Gjermani, një gjykatë ushtarake u mblodh për të gjykuar Sholtic në mungesë për tradhti. Megjithatë, i pandehuri kishte shumë miq të vendosur në radhët e ushtrisë, dhe ata arritën ta vononin gjyqin derisa mbaroi lufta, duke shpëtuar kështu gruan dhe fëmijët e Sholtic nga ekzekutimi apo burgimi

# DITRIH VON SHOLTIC

## NAZISTI QË SHPËTOI PARISIN



Në gushtin e vitit 1944, Adolf Hitlerit, i kishin mbetur shumë pak nga arritjet e tij të dikurshme të luftës. Nga Tripoli në Romë dhe Kiev, metropolet e pushtuara prej tij ishin rimarrë nga armiku. Ai sapo kishte humbur kryeqytetin e parë që kishte pushtuar gati 5 vjet më parë, teksa Ushtria e Kuqe e Josif Stalinit çliroi Varshavën.

Në kohën kur marshuan sundimtarët e rinj, kryeqyteti polak ishte një grumbull rrënojash ende në flakë. Qe një situatë e cila e joshte Fyhrerin: Nëse Hitleri dhe Gjermania nuk mund të kishin Varshavën, e pse duhet ta kishte dikush tjetër? Enjëta gjë vlente edhe për Parisin. Larg Varshavës, një amerikan i gjithëpushtetshëm, ishte gjithashtu i shqetësuar për fatin e kryeqytetit francez. Për gjeneralin Duajt Ajzenhauer, Parisi, bërthama kulturore dhe artistike e qytetërit perëndimor, përbënte një dhimbje koke të madhe.

Dy kilometra në brendësi nga bregu i Normandisë, komandanti suprem i aleatëve vendosi me ngurrim të shtyjë çlirimin e "Qytetit të Dritave". Një raport prej 24 faqesh, paralajmëronte se çlirimit i Parisit do të kufizonte seriozisht aftësinë e aleatëve perëndimorë, për të mbajtur nën presion mbi gjermanët diku tjetër. Ai sugjeroi sugjeroi një plan alternativ, sipas të cilit gjenerali britanik Bernard Montgomeri, do të të sulmonte në lindje midis lumenjve Senë dhe Oiz, dhe çlironte portin strategjik të Le Havre, duke neutralizuar vend-lëshimet e raketave V-1 dhe V-2 në Pa Dë Kale.

Ndërkohë, armata e XII amerikane mund të lëvizte në jug të Parisit për të kaluar Senën në Melun, për të marshuar rreth 100 kilometra në veri të Reimsit, dhe pastaj për t'u kthyer në perëndim dhe bashkuar në Amiens. Një betejë shkatërruese urbane në Paris do të shmangej, terreni në fjalë ishte i përshtatshëm për kalimin e ushtrisë, dhe garnizoni gjerman i qytetit do të neutralizohej me rrethim, dhe jo me sulme të drejtpërdrejta. Operacioni u vendos paraprakisht që të fillonte diku midis 15 shtatorit dhe 1 tetorit 1944. Kur Shari De Gol mësoi mbi planin për të anashkaluar Parisin dhe për të vonuar çlirimin, ai u bind se amerikanët kishin ende arsye të panjohura, në favor të një komploti për të shkatërruar të ardhmen e tij politike.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, gjermanët ishin zhgënjyer në përpjekjet e tyre për të pushtuar Parisin. Dy milionë prej tyre, kishin vdekur në baltovinat e përgjakura të Frontit Perëndimor. Një nga të mbijetuarit ishte pikërisht Adolf Hitleri. Katër vite pasi nazistët kishin hyrë triumfist në kryeqytetin francez, ai ishte i fiksuar për ta mbrojtur atë më çdo kusht. Megjithatë, Hitleri e kuptoi gjithashtu se edhe mund ta humbiste Parisin. Nëse çlirimi i qytetit ishte i afërt, ai vendosi që kryeqyteti francez të shkatërrohej.

Pas 3 vitesh shërbimi të shquar në frontin rus, gjenerali Ditrih von Sholtic u soll në frontin perëndimor nga Fyhreri. Pas atentatit të dështuar ndaj tij më 20 korrik, Hitleri kishte pak besim tek besnikëria e komandantëve të tij ushtarakë. Por tek Sholtic, ai besonte se ai e kishte gjetur njeriun e tij për një mision monumental. Trashëgimia familjare e Sholtic e gjeneratave të militarizmit prusian, i linte pak hapësirë një fryme të pavarur. Kur udhëhoqi pushtimin gjerman të Holandës në pranverën e vitit 1940, ai urdhëroi formacionet e avionëve bombardues të bënin pluhur e hi Roterdamin, përpara se qyteti të kishte shansin të dorëzohej. Ditrih von Sholtic, ishte realisht një shkatër-

rues i aftë i qyteteve, por kur mbërriti në Paris si guvernator i ri ushtarak, pati disa takime që e ndryshuan rrënjësisht si njeri. Ai e kishte takuar për herë të parë Hitlerin në një takim veror në vitin 1943 në frontin rus, duke u mahitur nga personaliteti i fuqishëm dhe besimi ngjites që impononte Fyhreri.

Por kur shkoi në selinë e tij në Rastenburg, Prusinë Lindore, një vit më vonë, ai u zhgënjye tërësisht. Shëndeti i Hitlerit ishte shkatërruar nga presioni i madh psikologjik, dhe siç dyshonin disa mjekë edhe nga sëmundja e Parkinsonit. Hitleri e caktoi guvernator të Parisit, duke e porositur të mos kishte asnjë mëshirë ndaj të gjitha akteve civile të mosbindjes apo terrorizmit. Duke lënë pas kompleksin pyjor të Hitlerit, Sholtic e kuptoi se këtë herë nuk bëhej fjalë për ndonjë qytet industrial apo bujqësor në stepat ruse, për Parisin, qytetin më të bukur në botë.

Për herë të parë në jetën e tij, Sholtic mendoi të mos i bindej një urdhri të drejtpërdrejtë nga lart. Pas mbërritjes në komandën e tij të re, ai u informua mbi urdhrat e tmerrshme për një tërheqje në stilin e tokës së djegur, në rast se trupat gjermane nuk do të ishin në gjendje të mbanin qytetin. Shumë shpejt,



avokat i mirë i Parisit zoti Tatinger. E keni bërë mirë detyrën tuaj. Po ashtu edhe unë, si gjeneral gjerman, duhet të bëj detyrën time". Por a do të ishte vërtet kështu? Në mëngjesin e 19 gushtit, forcat goliste nisën një sulm ndaj forcave gjermane. Ndërsa gjermanët reagon me pancerat e tyre, shkatërrimet në qytet nisën të shtohen. Gjenerali Ajzenhauer përjetoi një përzierje emocionesh teksa priste ardhjen e De Golit në selinë e tij në Grenvil, por ku mbizotëronte zemërimi.

Kryengritja pariziane e kishte tërbuar. Pa ndihmën e menjëhershme nga aleatët, revolta kishte gjasë të shtypej, dhe Parisi do të pësonte të njëjtin fat si Varshava. Ajzenhauer e kuptoi se ai dhe aleatët perëndimorë në tërësi, do të mbaheshin përgjegjës si gjermanët, nëse nuk do arrinin ta parandalonin këtë katastrofë, por kjo mund të sabotonte gjithë kalendarin e luftës në Europë, dhe të zgjaste me disa muaj konfliktin e tmerrshëm. Në qytet, rebelëve po u mbaronte municioni, dhe gjermanët po i shtypnin me një dhunë në rritje. Në mesin e luftimeve, gjermanët minuan bodrumin e "Les Invalides"; që nëse do të shpërthente mund të shkatërronte Muzeun e Ushtrisë Franceze, galerinë e artit ushtarak, kazermat 400 vjeçare, dhe varrin e Napoleon Bonapartit.

Mëngjesin e 23 gushtit, 4 inxhinierë SS po inspektonin këmbët mbështetëse të Kullës Eiffel, duke kërkuar vendet më të mira për të vendosur eksplozivin. Sholtic rrezikoi jetën e tij dhe të familjes, duke e gënjyer gjenerajlejtantin Hans Shpidel, se shkatërrimi i qytetit tashmë kishte filluar. Gjermanët po forconin perimetrin e tyre mbrojtës në perëndim të kryeqytetit, por ishte tepër vonë. Armata e II-të franceze dhe Divizioni IV i këmbësorisë amerikane, ishin gati të nisnin goditjen. Luftwaffe kishte marrë urdhrat nga Hitleri për të kryer sulm të madh ajror mbi Paris, por Sholtic kundërshtoi duke thënë se një sulm i tillë "do të vriste po aq shumë gjermanë sa edhe parisienë". Ai u dorëzua dhe arrestua mesditën e 25 gushtit nga forcat franceze. Në Gjermani, një gjykatë ushtarake u mblodh për të gjykuar Sholtic në mungesë për tradhti. Megjithatë, i pandehuri kishte shumë miq të vendosur në radhët e ushtrisë, dhe ata arritën ta vononin gjyqin derisa mbaroi lufta, duke shpëtuar kështu gruan dhe fëmijët e Sholtic nga ekzekutimi apo burgimi. (HiStoryNet)

kompania e xhenerierëve nisi vendosjen strategjike të eksplozivëve. Pajisjet elektrike dhe ato ujore patën prioritetin më të madh, por strukturat e para të minuara ishin urat shekullore mbi Senë. Pa këto ura, çdo ushtri do ta kishte të vështirë të përparonte me shpejtësi. Më 16 gusht, Hitleri urdhëroi drejtuesit e Gestapos të evakojnë qytetin. Më 17 gusht, Sholtic mori një urdhër nga Feldmarshalli Gynter von Kluge ku thuhej: "Unë jap urdhër për shkatërrimin e parashikuar të Parisit!". Gjenerali u gjend midis prires së ngulitur prusiane për të zbatuar urdhrin nga lart, dhe vetëdijes se do të ishte një akt vandal, për të cilin ai do të mbante një përgjegjësi të përjetshme historike.

Po atë ditë Sholtic shkoi në zyrën e Pier Tatinger, kryebashkiakut të Parisit. Ky u alarmua nga eksplozivët e vendosur në të gjithë qytetin, dhe i kërkoi shpjegime. Ai u trondit nga përgjigja e Sholtic: "Ju duhet të kuptoni se duhen marrë disa masa. Është detyra ime, të ngadalësoj sa më shumë të jetë e mundur përparimin e aleatëve". Papritmas, Sholtic u prek nga një nga sulmet periodike të astmës, duke nisur të kollitej në mënyrë të pakontrollueshme. Duke e shoqëruar për në ballkon për pak ajër të pastër, Tatinger pa poshtë mbi kopshtin e bukur të Tylërive, dhe u frymëzua. Më poshtë, një vajzë e re dhe e bukur e po e ngiste biçikletën e saj në rrugën de Rivoli; në zonat e lëmuara të Le Notrit, fëmijët po luanin me varkat e tyre prej letre; dhe përtej kësaj qëndronte simboli i qytetit të dritës, Kulla Eiffel.

Apeli i francezit ishte i fuqishëm: "Shpesh një gjenerali i jepej rasti të shkatërronjë, dhe rrallë të ruajë. Imagjioni që një ditë mund, ju mund të ngjiteni sërish në këtë ballkon, si një turist, të shihni edhe njëherë këto monumente dhe të mund të thoni: Një ditë unë kisha mundësi t'i shkatërroja, por i ruajta si një dhuratë për njerëzimin!".

Sholtic qëndroi një moment i heshtur dhe pastaj tha: "Ju jeni një



HISTORIA GRUAS QË PRAKTIKOI QINDRA ABORTE, PËR TË SHPËTUAR JETËT E GRAVE HEBREJE

# “UNË ISHA DOKTORESHË NË AUSHVIC”

“Pashë gra shtatzëna të rrahura me shkopinj dhe kamxhikë, të kafshuara nga qentë, të kapura nga flokët dhe të goditura në stomak nga çizmet e rënda gjermane. Në ato momente, derisa i binte të fikët i tërhiqnin drejt krematoriumit të gjalla. Atëherë vendosa që kurrë më nuk do të kishte shtatzëna në Aushtvic”, shkruan në kujtimet e veta “I was a doctor in Auschwitz”



Në vitin 1982 në moshën 72 vjeçare udhëtoi nga Izraeli drejt Nju Jorkut për të marrë një çmim mirënjohje. Gisella Perl, gjinekologja, e cila ishte e burgosur dhe mjekë e grave në kampin e përqendrimit nazist u shpreh se më e keqja që mund t'i ndodhte dikujt në Aushtvic ishte të ishte një grua shtatzënë. Ajo rrezikoi jetën, ashtu siç e kujtoj në kolegët e saj dhe historianët e Shoah-s, George Weisz dhe Konrad Kwiet për të shpëtuar një numër të pallogaritshëm grash; i ndihmoi të abortonin, ose të provokonte një lindje të parakohshme në rast se kishin shumë muaj shtatzënie dhe në këtë mënyrë të mbijetonin. Heinrich Himmler ishte shprehur se nuk kishte kuptim të shfarosje të rriturit dhe të lije fëmijët të rritshin dhe të hakmerreshin kundër fëmijëve të tyre dhe nipërve.

Kështu, në mesin e atyre 6 milionë të vrarë, pjesa më e madhe hebrej, 1,5 milionë ishin fëmijë. Kur mbërrinin në kampin e përqendrimit femrat shtatzëna shkonin direkt në dhomat e gazit. Ato që e fshihnin për një periudhë kohe e vononin këtë fund sepse nuk mund të punonin dhe tradhtoheshin nga ky fakt. Në rast se ishin në fund të shtatzënisë fëmijët kur lindnin mbyteshin ose u injektohej një injeksion vdekjeprurës. Josef Mengele, i cili realizonte eksperimente mjekësore të dhunshme mbi të burgosurit kishte një farë parapëlqimi për binjakët, për të paafët dhe për gratë shtatzëna. “Mengele më tha që ta informoja për këdo grua shtatzënë”, – kujton Perl në një artikull për “The New York Times”. “Më tha që do të shkonin në një kamp tjetër për të marrë ushqim më të mirë, madje edhe qumësht. Gratë e lajmëronin vetë atë; jam shtatzënë”. Megjithatë Perl e dinte që ishte një gënjeshtër.

Në kujtimet e veta “I was a doctor in Auschwitz” (Isha një mjekë në Aushtvic) kujton një ditë të vitit 1944, në afërsi të krematoriumit: “Pashë gra shtatzëna të rrahura me shkopinj dhe kamxhikë, të kafshuara nga qentë, të kapura nga flokët dhe të goditura në stomak nga çizmet e rënda gjermane. Në ato mo-

mente, derisa i binte të fikët i tërhiqnin drejt krematoriumit të gjalla. Atëherë vendosa që kurrë më nuk do të kishte shtatzëna në Aushtvic”.

Dhe siç shprehen Weisz dhe Kwiet për revistën mjekësore “Rambam Maimonides” iu bashkua historisë së burrave dhe të grave të burgosura që rrezikojnë jetën për të shpëtuar të tjerët. Në rastin e saj u përball me një dilemë morale, e cila ishte një sfidë e padiskutueshme. Ky vendim i kushtoi shumë, por kuptoi se nëse ajo nuk i ndërpriste shtatzënitë si nënat dhe fëmijët do të vdisnin njësoj. Pavarësisht besimit profesional dhe atij fetar si mjekë dhe si hebreje praktikuese, Perl filloi të realizonte aborte mbi një dyshe me të pistë, vetëm me duar, pa i larë, pa instrumente mjekësore, pa anestezi dhe shumë herë në krevatet e marinarit të mbipopulluara dhe të pistë, brenda barakave për gra në Aushtvic. Perl i dha fund shumë jetëve të fetuseve me shpresën se nënat do të mbijetonin dhe më pas ndoshta mund të kishin fëmijë.

Kishte raste që u ndesh me shtatzëni të avancuara, të cilat nuk e lejonin abortin. Atëherë çante qesën amniotike dhe zgjeronte qafën e mitrës me dorë për të nxitur lindjen. Në këto raste fëmijët prematurë vdisnin pothuaj menjëherë shpjegojnë historianët. Pa një kërcënim të zbulimit të shtatzënisë gratë mund të punonin. Perl e kujton kë-



shtu një rrethanë: “Asnjëherë diku sh do ta kuptoj se çfarë do të thoshte për mua të vrisja ato bebe, por nëse nuk do ta kisha bërë si nënat dhe fëmijët do të ishin vrarë mizorisht”. Në një rast Perl e shtrëngoi një djalë tri ditësh, pasi e kishte puthur më parë.

Gisella Perl lindi në 1907 në një vend të hebrenjve ortodoksë në Sighetu Marmatiei në Transilvani, Rumania. Ishte një vajzë e avancuar, e

para hebreje që mbaroi gjimnazin në fshatin e saj dhe e para grua që hyri në mjeksi. U martua dhe pati dy fëmijë; djalë dhe vajzë. Punonte si gjinekologë kur nazistët pushtuan rajonin në maj 1944. Brenda 5 ditësh, gjermanët deportuan 14.000 hebrej nga fshati, pjesa më e madhe për në Aushtvic ku vdiqën menjëherë. Të burgosur bashkë me të i shoqi dhe djali; vajza u fsheh nga një familje. Kur mbërriti në kamp u nda nga familja e saj dhe u detyrua të merrej me dhurimet e forcuara të gjakut të të burgosurave për t'iu ardhur në ndihmë ushtarëve gjermanë. “E harruan rassenschande, kontaminimin me gjakun inferior. Ishim shumë inferiorë për të jetuar, por shërbyem për të mbajtur gjallë ushtrinë gjermane me gjakun tonë”, shkroi ajo në kujtimet e saj.

Kur Mengele e mori vesh që ishte gjinekologë i ndryshoi detyrë. Pa dhoma, pa mjete trajtonte pacientët vetëm me zërin e saj. U rrëfente histori të bukura, i thoshte se një ditë do të festonin ditëlindjen, që një ditë do të këndonin. “I njëjti dëshpërim që po më mbyste u shndërrua në një ndjenjë rebelimi që më nxori nga letargjia dhe më dha një motiv për të jetuar”. Nuk dihet sa gra ka shpëtuar, por e ndjente se edhe ato i shpëtonin të sajën.

“Unë duhej të mbetesha gjallë. Varej nga unë shpëtimi i grave shtatzëna nga dhomat e gazit. Varej nga unë shpëtimi i nënave dhe nuk kishte mënyrë tjetër veçse shkatërrimit të jetëve të fëmijëve të tyre të palindur”, kujton ajo. Evakuimi i kampit në vitin 1945 kur po afrohej ushtria ruse çoi drejt vdekjes çerekun e 60.000 të burgosurve në Aushtvic. Në atë periudhë Perl ndodhej në një kamp tjetër në afërsi të Hamburgut, kur u çliruan. Kur mbërritën trupat britanike e gjetën duke asistuar procesin e lindjes së një gruaje. Ishte djali i parë hebre që lindi në liri në Bergen-Belsen. Më pas kërkoi të shoqin dhe djalin në Gjermani për muaj të tërë.

Në fund zbuloi se i kishin vrarë. Në vitin 1947 u përpoq të vetëvritej, i mbijetoi dhe emigroi në Amerikë. “Kur mbërriti u dyshua se Perl kishte kryer krime lufte”, shprehen Weisz dhe Kwiet. “Ishte makthi që e priste dhe që Joseph Sargent e rrëfeu në filmin Out of the Ashes”. Arriti të provonte se nuk kishte bashkëpunuar me Mengelen dhe se dëshmia e saj ishte kyç për dënimin e të paktën një mjeku në Aushtvic dhe se dëshmia e saj ishte e ngjashme me dëshmitë e të mbijetuarve të tjerë. Në një rast u njoh me Eleanor Roosevelt dhe me ndihmën e saj mori nënshpëtimin amerikan dhe hapi një klinikë obstetrike në Manhattan, kushtuar në pjesën më të madhe të mbijetuarve të Shoah-s. Rimori jetën akademike dhe investoi në fertilizime në “Hospital Mount Sinai”, ku solli në jetë më shumë se 3000 fëmijë. Vdiq në 16 dhjetor 1988 në Herzliya, Izrael ku kishte emigruar për të jetuar me vajzën. (bota.al)



LETRA ENJË NËNE

# AJO QË DOJA T'U THOSHA MËSUESVE TË FËMIJËS TIM

"Ju shkruaj, sepse shpesh herë jua kam shumë zili kohën që kaloni me të. Sepse e shihni të matet me gjërat e vështira dhe të mrekullohet përpara një zbulimi të vockël"

Pikësëpari, faleminderit, sepse fëmija im kthehet në shtëpi me një sërë gjërash për të treguar. Pastaj dua t'ju kërkoj që ta dëgjoni, edhe atëherë kur duket sikur nuk ka një gjë të saktë për të thënë dhe po përpiqet të gjejë fjalët e duhura. Dëgjojeni sepse, nëse keni durim ta bëni, në mënyrën e vet do të dijë t'ju bëjë të kuptoni se çfarë mendon.

Ka një gjë që e bën të lumtur, shumë të lumtur. Ajo quhet

"Imagjinatë". Bëjeni të studiojë, mësojini si llogaritet sipërfaqja e një trekëndëshi, çfarë është fotosinteza dhe përse disa fjalë në shumës mbarojnë me "e", por lëreni edhe të imagjinojë se çfarë do të bëjë kur të rritet. E di, një ditë thotë se dëshiron të bëhet këngëtar i diplomuar në zoologji, ditën tjetër peshkatar që nuk do hajë kurrë peshqit që kap. E di, kështu është. Imagjino pa e vrarë mendjen që i duhet të

imagjinojë gjithmonë të njëjtën gjë.

Ka një gjë që, nuk e kapërdin dot. Quhet "poshtërim". Qortoje-ni, vendosini një notë në fletoren e shtëpisë, por mos shkoni përtej kësaj. Nuk vlen. Një gjë e fundit, e vockël. Bëjeni të ndjehet special, edhe me koston që të egzageroni pak. Do të vijë një moment kur do ia masin të gjithë gjërat që bën, dhe nuk do të ketë më vend për gjysmë gjëra. Por

tani, është fëmijë dhe po përpiqet të kuptojë kush është, të "masë" botën, të rrëzohet dhe të ringrihet në këmbë. Ka kohë për vlerësime objektive, një "bravo" e bën zemrën mal.

P. S. Do të doja t'ju lutesha edhe të mos i bërtisni nëse shkruan keq, dhe bën vizatime që ngajnë me shkarravina. Nuk jua thotë, por mbetet keq.

Kaq. (Dhe punë të mbarë).  
Një nënë



## "Hamburgeri i pamundur" zëvendëson mishin me...

Të konsumosh mish pa përdorur mish. Kjo është sfida e një kompanie amerikane, e cila po përpiqet të krijojë "hamburgerin e pamundur", me origjinë vegjetale, por që ka shijen e mishit. Objektivi është mjaft ambicioz për të arritur suksesin në ndryshimin e zakoneve ushqimore të mishngrënësve dhe për të ndihmuar njëkohësisht edhe ambientin.

Një profesor i biokimikës në Universitetin Princeton, Pat Brown ka krijuar shoqërinë "Ushqimi i Pamundur" (Impossible Food), çka shpjegon edhe synimet e tij. Arsyeja është që të reduktojë impaktin mjedisor të rritjes industriale të kafshëve për konsum.

Profesori është nisur nga përdorimi i hamburgerit në Tokën Mëmë, Ahba, ku konsumi është tejet i lartë. Nëse vetëm 50% e mishit në fast food do të zëvendësohej me përmbytjen e re vegjetale, atëherë do të evitohej shkarkimi në ambient i 45 mln mert kub karbon, do të kursehej uji i përdorur nga 90 mln persona për një vit dhe do të liroheshin 190 mijë km katror tokë që sot janë të destinuar për rritjen e kafshëve të konsumit.

THE IMPOSSIBLE  
BURGER



## E kemi përdorur gabim antidjersën

sës, duke ju shkaktuar edhe ju më shumë shqetësime. Në fakt, antidjersa ka një rregull në përdorimin e saj, duhet të përdoret gjithmonë në darkë. Pra, pasi keni kryer rutinën tuaj para se të flini gjumë, mos harroni të hidhni edhe antidjersën.

Përdorimi i antidjersës para se të flini gjumë bëhet për faktin se ajo bën të mundur mbylljen e poreve të djersës, shkruan noa.al. Menjëherë pasi të zgjoheni nga gjumi vijoni ditën tuaj normalisht dhe to të shikoni se sasia e djersës do të jetë reduktuar.

Produktet e kozmetikës janë të larmishme dhe na ndihmojnë në jetën e përditshme për të shmangur disa gjëra të pakëndshme. Një ndër to është djersa, për të cilën përdorim deodorantë të

ndryshëm. Por ka një fakt, antidjersën e keni përdorur gabim. Thujse të gjithëve na ndodh që ta përdorim pasi dalim nga du-shi.

Por ky është një nga gabimet

që bëhet në përdorimin e produkteve që luftojnë djersën dhe aromën e keqe të saj. Hedhja e antidjersës në mëngjes, pasi bëni banjo apo para se të dilni, bën të kundërtën, e shton sasinë e djer-

## Një në çdo 50 udhëtarë gjen dashurinë e jetës në avion

Sipas sondazhi nga HSBC, i cili kërkoi më shumë se 5.000 udhëtarë anembanë globit të tregonin përvojat e tyre të fluturimit dhe lidhjet që kanë bërë aty, del se një në çdo 50 udhëtarë ka gjetur dashurinë e jetës në avion. Anketa u krye në korrik 2018 dhe përfshin përgjigjet nga udhëtarë të 141 vende të ndryshme.

Kjo anketë zbuloi gjithashtu se 16 për qind e udhëtarëve ki-

shin formuar një lidhje biznesi gjatë një fluturimi, ndërsa 14 për qind kanë bërë miqësi të gjata me njerëzit që takoheshin gjatë fluturimit.

Ndërsa 51 për qind e të anketuarve treguan se kanë pasur bisedë me njerëz të huaj gjatë një fluturimi të tyre.

Nëse shpresoni të takoni një person të veçantë gjatë fluturimit tuaj të ardhshëm, ka disa

aplikacione që mund t'ju ndihmojnë. Për shembull, "btrfly" ju lidh me udhëtarët në 380 aeroportet anembanë botës kur futni informacionin tuaj të fluturimit ose aeroportin, ndërsa aplikacioni me bazë në internet Planely punon si një rrjet social për qiellin, duke ju lidhur me udhëtarët tjerë që kanë interesa të përbashkëta, mund të takohen në fluturim ose në terren.



"Çdo futbollist i cili posedon cilësi futbollistike dhe njerëzore që të jetë pjesë e kombëtares, ai është në kombëtare. Ne jetojmë si një familje", thotë Angellovski

Kombëtarja e Maqedonisë në futboll, nëpërmjet garës së re të UEFA-s, Liga e Kombeve, do të tentojë që për herë të parë në historinë e saj të sigurojë kualifikim në Kampionatin Evropian. Të përzgjedhurit e trajnerit Igor Angellovski ndeshjen e parë nga Liga e Kombeve do ta zhvillojnë në terrenin mysafir me kombëtaren e Gjibraltarit, më 6 shtator të këtij viti, ndërsa tri ditë më vonë, do t'i masin forcat kundër kombëtares së Armenisë në Arenën nacionale "Filipi i Dytë" në Shkup. Në Ligën e Kombeve, Maqedonia është në ligën "D", ku në kuadër të grupit 4 do të luajë me Armeninë, Gjibraltarin dhe Lihtenshtajnin.

Igor Angellovski është trajneri i kombëtares së Maqedonisë në futboll që nga tetori i vitit 2015. Në bisedën për Anadolu Agency (AA) ai ka folur për sfidat me të cilat ballafaqohet ai si trajner, për situatën me futbollin në Maqedoni dhe rajon si dhe për mundësinë që sa më shumë tifozë të jenë të pranishëm në tribuna. Angellovski

ANGELLOVSKI PË ANADOLU AGENCY

## LIGA E KOMBEVE, NJË SHANS I MADH PËR MAQEDONINË



thotë se Liga e Kombeve është projekt i UEFA-s i cili u ofron mundësi kombëtares "të vogla" të arrijnë deri te një kampionat evropian.

Ai thekson se Maqedonia e sheh shansin e saj përmes Ligës së Kombeve sepse është një ligë në të cilën luhet me rivalët që janë në të njëjtin nivel apo të ngjashëm, por, siç deklaroi ai, në futboll ka kohë që nuk vlen rregulli se favoriti gjithmonë fiton, sepse cilësia është e barabartë, duke vënë në dukje se edhe në ligën "D" ka kombëtare cilësore.

"Për Maqedoninë kjo është një mundësi e madhe dhe e gjithë kjo tek ne zgjon motive të mëdha që të hyjmë maksimalisht seriozisht në këtë garë dhe të bëjmë çmos për të shënuar sukses që futbollit dhe ekipit kombëtar të Maqedonisë do t'i japë një ngritje dhe t'i ven-

dosë aty ku meritojnë të jenë", tha Angellovski. Ai thotë se atmosfera në ekipin kombëtar është në një nivel fenomenal, sepse në 11 ndeshjet e fundit ka vetëm një humbje nga Spanja, duke shtuar se skuadra është një vit e gjysmë rresht pa disfatë dhe se lojtarët kanë patur një periudhë të mrekullueshme.

"Në periudhën e kaluar, sa i përket kualifikimeve, kemi qenë në një grup të vështirë me Italinë dhe Spanjën. Fituam 11 pikë, që është renditja e dytë e deritanishme në histori deri tani. Për fat të keq, ne përfunduam në vendin e pestë, që nuk është një sukses për mua, por këto ndeshje, pikët që fituam dhe rezultatet që kemi arritur na japin të drejtën të shprejsojmë se ne jemi në rrugën e duhur, se duhet të vazhdojmë me të njëjtën ritëm dhe me mënyrën

e njëjtë të punës, që në të ardhmen të regjistrojmë rezultate edhe më të mira", tha Angellovski.

Për përzgjedhjen e lojtarëve në ekipin kombëtar, thotë se ai, si një njeri dhe si trajner, nuk i ndan lojtarët fare se cilit grup etnik, feje apo kombi i takojnë, por që për të, të rëndësishme janë karakteristikat njerëzore dhe futbollistike.

"Çdo futbollist i cili posedon cilësi futbollistike dhe njerëzore që të jetë pjesë e kombëtares, ai është në kombëtare. Ne jetojmë si një familje. Unë kurrë nuk i dalloj dhe nuk do t'i dalloj njerëzit sipas ngjyrës së lëkurës, bazës fetare apo kombëtare. Për mua, njeriu është njeri dhe sipas asaj i njoh cilësitë e tij. Jam i lumtur që punoj me djem të tillë dhe kemi një atmosferë të mrekullueshme ku secili respekton secilin. Vetëm në këtë mënyrë mund të shënojmë

rezultate", thekson trajneri Angellovski. I pyetur nëse një ligë cilësore vendore është parakusht për një kombëtare të mirë dhe cilësore që ka potencial për të arritur sukses, thotë se në çdo rast është një nga parakushtet, duke shprehur shpresën se klubet në Maqedoni do të rriten gjatë viteve.

Ai shprehu keqardhje që këtë vit Shkëndija nuk arriti të hyjë në fazën grupore të Evropa Ligës, duke thënë se kjo skuadër ishte me të vërtetë më mirë se Rosenborg.

Ai gjithashtu kujton se vitin e kaluar një gjë e tillë i shkoi për dore Vardarit dhe vuri në dukje se vetëm nëpërmjet paraqitjeve dhe investimeve të tilla siç investohen në Vardar, Shkëndijë, Akademia Pandev dhe të tjera, vjen edhe deri tek sukseset në kombëtare.

(Anadolu Agency)

RRËFIMI I GREZDËS

## NUK MË BESOHEJ KUR MË TELEFONOI GERRARDI



Talenti i Kombëtares, Eros Greza, i cili u transferua së fundmi te Rejnshersi i Stiven Xherard ishte i ftuar në emisionin "Zona Gol" të Ilda Bejlerit, ku foli për transferimin te skuadra skoceze dhe zbuloi se si e kontaktoi legjenda e Liverpoolit për tu bërë pjesë e skuadrës së tij. "Jam në Paris për të marrë lejen e punës dhe vizën. Do të jem këtu deri ditën e hënë e pastaj të grumbullohem me ekipin kombëtar", u shpreh Greza për "Supersport"

Javën e kaluar ndodhi gjithçka shumë shpejt, më kishin ndjekur për një kohë të gjatë dhe nuk e dija. Më kontaktoi direkt Stiven Xherard në telefon, nuk i besoja në fillim, por pastaj e pashë që biseda po bëhej serioze dhe akordi u arrit shumë shpejt.

Kur erdha në Skoci, pashë ambientin, qendrën, ngela pa fjalë.

Është një klub i madh me histori, kanë 50 mijë shikues pavarësisht se me kë luajnë. Me Xherard nuk isha takuar asnjëherë më parë, vetëm kur më mori në telefon. Kur erdha në Skoci më takoi personalisht, ishte një përshtypje e parë shumë e mirë, njeri i mirë, i thjeshtë dhe më tregoi projektet. Ka shumë besim te unë, pret shumë nga unë.

**A ke folur me Panuçin për transferimin te Rejnshersi, të ka uruar ai?**

Kam kontaktuar me Panuçin dhe ai ishte ndër personat e parë që e ka marrë vesh për interesimin e Rejnshersi. Patjetër që më ka uruar. Flas vazhdimisht me Panuçin, sepse do të dijë për gjendjen time, për shkak se unë

nuk kam luajtur asnjë ndeshje këtë sezon.

**Rikthimi në ekipin Kombëtar pas dëmtimi...**

Për Kombëtaren do jap edhe gjënë e fundit. Gjithmonë jap maksimumin dhe do të jep. Mezi pres ato ndeshjet e Kombëtares, janë një ndjenjë komplet ndry-

she nga ato me klubet. Gjithmonë kërkoj shumë më shumë. Dua të përsërisim sukseset e vitit 2016, ky është qëllimi ynë i vetëm.

**Kur do të shkosh në Skoci?**

Të hënë do marrë vizën për lejen e punës, të martën do vij në Tiranë.

Në bazë të nenit 68 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ndërsa në lidhje me nenin 37 paragrafi 6 dhe 38 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për mbrojtje të të dhënave personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/2005, 103/2008, 124/10, 135/11, 43/14, 153/15, 99/16 dhe 64/18), Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e mbartur më datë 29 gusht 2018, solli

**VENDIM  
PËR PUBLIKIM TË SHPALLJES PUBLIKE PËR ZGJEDHJE TË ZËVENDËSDREJTORIT TË DREJTORISË  
PËR MBROJTJE TË TË DHËNAVE PERSONALE**

I. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë publikon shpallje publike për zgjedhje të zëvendës drejtorit të Drejtorisë për mbrojtje të të dhënave personale (në tekstin e mëtejshëm: Drejtoria).

II. Për zëvendës drejtor të Drejtorisë mund të zgjidhet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK, gjegjësisht shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit fakulteti juridik;
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune në sferën e punëve juridike;
- 5) posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
  - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
  - IELTS – së paku 6 pikë,
  - ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
  - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
  - BULATS – së paku 60 pikë ose
  - APTIS – së paku niveli B2.

III. Fletëparaqitja për pjesëmarrje në këtë shpallje, biografia personale dhe dokumentet e nevojshme me të cilat dëshmohet përmbushja e kushteve nga pika II nën-pika 1), 2), 3) dhe 4) e këtij vendimi, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, kandidatët e interesuar duhet t'i parashtrijnë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në afat prej 20 ditëve nga dita e publikimit të këtij vendimi në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

IV. Zëvendës drejtori i cili do të zgjedhjet sipas kësaj shpallje obligohet që më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes të përmbushin kushtin nga pika II nën-pika 5) e këtij vendimi për njohje të gjuhës angleze dhe deri te Komisioni për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të parashtrijnë dëshmi për përmbushjen e tij.

V. Ky vendim do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në gazetën "Nova Makedonija", "Slloboden Peçat" dhe "Koha".

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Numër 08 - 4995/1  
29 gusht 2018  
Shkup

**KRYETARI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
MAQEDONISË**  
M-r Talat Xhaferi, d.v

Se dokumenti është i besueshëm me origjinalin konfirmon:

**ZËVENDËSSEKRETARI GJENERAL I KUVENDIT  
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Nexhbedin Ibraimi

Në bazë të nenit 68 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe nenit 11-d të Ligjit për avokat të popullit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/2003, 114/2009, 181/16, 189/16 dhe 35/18), Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e mbartur më datë 29 gusht 2018, solli

**VENDIM  
PËR PUBLIKIM TË SHPALLJES PUBLIKE PËR ZGJEDHJE TË SHOQATAVE NGA  
SFERA E TË DREJTAVE TË NJERIUT, TË DREJTËS POLICORE DHE DREJTËSISË**

I. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë publikon shpallje publike për zgjedhje të tri shoqatave nga sfera e të drejtave të njeriut, të drejtës policore dhe drejtësisë.

II. Shoqatat e zgjedhura emërojnë nga një përfaqësues për anëtar të jashtëm tek Avokati i popullit – mekanizëm për kontroll qytetare, me mandat prej një viti.

III. Anëtarët e jashtëm duhet të përmbushin kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK, gjegjësisht shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit dhe
- ka pesë vjet përvojë pune në organizata (shoqata) joqeveritare nga sfera e të drejtave të njeriut, të drejtës policore dhe drejtësisë

IV. Fletëparaqitja për pjesëmarrje në këtë shpallje dhe dokumentet e nevojshme për të dëshmuar se shoqata është nga sfera e të drejtave të njeriut, të drejtës policore dhe drejtësisë, dhe se ka person që përmbushë kushtet nga pika III e këtij vendimi, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, shoqatat e interesuara duhet t'i parashtrijnë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të këtij vendimi në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

V. Ky vendim do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në gazetën "Nova Makedonija", "Slloboden Peçat" dhe "Koha".

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Numër 08 - 4997/1  
29 gusht 2018  
Shkup

**KRYETARI I KUVENDIT TË  
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

M-r Talat Xhaferi, d.v

Se dokumenti është i besueshëm me origjinalin konfirmon:

**ZËVENDËSSEKRETARI GJENERAL I  
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Nexhbedin Ibraimi

Në bazë të nenit 68 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ndërsa në lidhje me nenin 31 paragrafët (3), (4) dhe (6) të Ligjit për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/2006, 86/2008, 6/10, 42/14, 148/15, 55/16 dhe 64/18) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e mbartur më datë 29 gusht 2018, solli

**VENDIM  
PËR PUBLIKIM TË SHPALLJES PUBLIKE PËR EMËRIM TË KRYETARIT DHE DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR  
MBROJTJE TË SË DREJTËS SË QASJES SË LIRË DERI TE INFORMACIONET ME KARAKTER PUBLIK**

I. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë publikon shpallje publike për emërim të kryetarit dhe dy anëtarëve të Komisionit për mbrojtje të së drejtës së qasjes së lirë deri te informacionet me karakter publik (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

II. Për kryetar të Komisionit mund të emërohet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK, gjegjësisht shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit fakulteti juridik;
- 3) ka të jetë vjet përvojë pune nga sfera e informimit dhe punëve juridike;
- 4) të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike;
- 5) posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
  - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
  - IELTS – së paku 6 pikë,
  - ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
  - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
  - BULATS – së paku 60 pikë ose
  - APTIS – së paku niveli B2.

III. Për anëtar të Komisionit mund të emërohet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK, gjegjësisht shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit fakulteti juridik;
- 3) ka pesë vjet përvojë pune nga sfera e informimit dhe punëve juridike;
- 4) të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike;
- 5) posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
  - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
  - IELTS – së paku 6 pikë,
  - ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,
  - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
  - BULATS – së paku 60 pikë ose
  - APTIS – së paku niveli B2.

IV. Fletëparaqitja për pjesëmarrje në këtë shpallje, biografia personale dhe dokumentet e nevojshme me të cilat dëshmohet përmbushja e kushteve nga pika II nën-pika 1), 2) dhe 3) dhe pika III nën-pika 1), 2) dhe 3) e këtij vendimi, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, kandidatët e interesuar duhet t'i parashtrijnë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në afat prej 20 ditëve nga dita e publikimit të këtij vendimi në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Kandidatët e interesuar, me dokumentet nga paragrafi 1 e kësaj pike duhet të parashtrijnë edhe deklaratë personale të vërtetuar në noter për përmbushje të kushtit nga nën-pika 4) e pikave II dhe III e këtij vendimi.

V. Kryetari dhe anëtarët të cilët do të emërohen sipas kësaj shpallje, obligohen që më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes të përmbushin kushtin nga pika II nën-pika 5) dhe/ose pika III nën-pika 5) e këtij vendimi për njohje të gjuhës angleze dhe deri te Komisioni për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të parashtrijnë dëshmi për përmbushjen e tij.

VI. Ky vendim do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në gazetën "Nova Makedonija", "Slloboden Peçat" dhe "Koha".

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Numër 08 - 5001/1  
29 gusht 2018  
Shkup

**KRYETARI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
MAQEDONISË**  
M-r

Talat Xhaferi, d.v

Se dokumenti është i besueshëm me origjinalin konfirmon:

**ZËVENDËSSEKRETARI GJENERAL I  
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Nexhbedin Ibraimi

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave të RM nr. 18-9102/2 të datës 16.08.2018, 18-9141 të datës 16.08.2018 dhe Vendimit për publikim të shpalljes numër 0401-2079/1 të datës 31.08.2018, të sjellë nga UD Drejtori i IPSSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup, publikohet

**SHPALLJE**

**a). Për punësim të 1 (një) personi Bashkëpunëtor i pavarur profesional - për kohë të pacaktuar.**

1. IPSSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup ka nevojë për të punësuar 1 (një) person për vendin e punës Bashkëpunëtor i pavarur profesional për kohë të pacaktuar.
2. Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj:
  - Të jetë shtetas i RM;
  - Të jetë i moshës së rritur;
  - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore;
  - Të mos i jetë shqiptuar ndalesë për kryerjen e veprimtarisë, detyrës ose profesionit.
3. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
  - Arsimit sipëror të mbaruar dhe deri në 2 (dy) vjet përvojë pune.
4. Orari javor i punës është 40 orë. Neto pagesa fillestare për Bashkëpunëtor i pavarur profesional është 23.029,00 denarë.
5. Si shtojcë të fletëparaqitjes kandidatët janë të obliguar që të parashtrijnë dokumentet në vijim:
  - Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt;
  - Biografi të shkurtë (CV);
  - Diplomë për arsim sipëror të mbaruar në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
  - Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
  - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
  - Kopje të letërnjoftimit të vërtetuar në noter;
  - Certifikatë se nuk ka ndalesë për kryerje të veprimtarisë, detyrës ose profesionit.
6. Afati për paraqitje të kandidatëve zgjatë 3 (tre) ditë pune nga dita e publikimit.
7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.
8. Fletëparaqitja së bashku me tërë dokumentacionin të parashtrihet në IPSSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup, lagjia Kozle pn, Shkup përmes postës ose në arkivin e IPSSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup me shenjë për Shpallje për punësim. IPSSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup

**b). Për punësim të 1 (një) personi Punëtor administrativ në sportel - për kohë të pacaktuar.**

1. IPSSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup ka nevojë për të punësuar 1 (një) person për vendin e punës Punëtor administrativ në sportel - për kohë të pacaktuar.
2. Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj:
  - Të jetë shtetas i RM;
  - Të jetë i moshës së rritur;
  - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore;
  - Të mos i jetë shqiptuar ndalesë për kryerjen e veprimtarisë, detyrës ose profesionit.
3. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
  - Arsimit mesëm të mbaruar, me ose pa përvojë pune.
4. Orari javor i punës është 40 orë. Neto pagesa fillestare për Punëtor administrativ në sportel është 15.194,00 denarë.
5. Si shtojcë të fletëparaqitjes kandidatët janë të obliguar që të parashtrijnë dokumentet në vijim:
  - Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt;
  - Biografi të shkurtë (CV);
  - Diplomë për arsim të mesëm të mbaruar në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
  - Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
  - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
  - Kopje të letërnjoftimit të vërtetuar në noter;
  - Certifikatë se nuk ka ndalesë për kryerje të veprimtarisë, detyrës ose profesionit.
6. Afati për paraqitje të kandidatëve zgjatë 3 (tre) ditë pune nga dita e publikimit.
7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.
8. Fletëparaqitja së bashku me tërë dokumentacionin të parashtrihet në IPSSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup, lagjia Kozle pn, Shkup përmes postës ose në arkivin e IPSSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup me shenjë për Shpallje për punësim. IPSSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup

UD Drejtor  
Drejtori medicinal  
D-r Angellço Andonovski

Drejtori organizativ  
Ekk Dip. Rijad Alimi

PANUÇI PËR DY SFIDAT DEBUTUESE NË LISTË E KOMBEVE

# NUK NDIEJ PRESION, AGOLLI DHE SHABANI...

Dua të  
kthehem  
në

## Juventus

Paul Pogba dëshiron të luajë krah me Cristiano Ronaldo. Francezi ju ka treguar zyrtarëve në Manchester United se dëshiron që të kthehet në Serie A, te Juventus, shkruan Express.co.uk. E ardhmja e Pogba ka qenë në pikëpyetje pak muaj prej kthimit në Old Trafford, pikërisht nga Juventus. Edhe raportet e tij me trajnerin Jose Mourinho nuk kanë qenë në nivel të kënaqshëm, prandaj ai tash kërkon largimin nga aty edhe pse shkoi për një vlerë rekorde.



Christian Panuçi i thotë të gjitha. Në konferencën për shtyp ku bëri publike listën e 25 futbollistëve që do të përfaqësojnë Shqipërinë në dy sfidat debutuese të kompeticionit më të ri Ligës së Kombeve, ndaj Izraelit dhe Skocisë. Trajneri i kuqezinjve foli për dy ndeshjet e radhës, për rikthimin e Agollit, për lënien jashtë të disa emrave me peshë, për presionin ndërsa u uroi shërim sa më të shpejtë Roshi dhe Sadikut dy futbollistëve që kanë pësuar dëmtime të rënda gjatë kësaj vere

### Sa e ndjen Kombëtarja presionin?

Këtu nis rrugëtimi jonë për objektivin e madh në European.

### Biseda me Agollin...

Unë gjithmonë kam thënë për Agollin, që duhet t'i gjejmë një zëvendësues për shkak të moshës së tij. Por, asnjë moment nuk kam thënë që ai nuk do jetë pjesë e jona. Unë nuk e kam thënë kurrë, jemi në një situatë ku Lenjani, Memolla, Aliji nuk luajnë. Për shkak të përvojës, e kam grumbulluar, do shohim nëse do luajë apo jo.

### Sot përmendni eksperiencën...

Gjatë një viti të takimeve të Shqipërisë, kam thënë që do na duhet një mbrojtës tjetër në vend të Ansit. Ndoshta, edhe pas dy vitesh, nëse ai është në formë të mirë, do e marr. Edhe Karabaku ka marrë një mbrojtës të majtë. Kam thënë, që në miqësore duhej të gjenim një mbrojtës të majtë, dhe kur të na nevojitej, do e thërrisim si tani. Duke parë që edhe Memolla e Aliji nuk janë. Në këtë moment, do na ndihmojë shumë, dhe do e thërrasim. Nëse pas dy viteve do na japë përsëri një dorë, pse jo.

### Sa i sigurt jeni për këtë listë...

Jemi një skuadër e mirë, nëse do jemi të plotë. Dikush mendon se jemi Brazili, por nuk jemi ata. Mavraj ka kohë që nuk luan, Grez-

da po ashtu. Roshi e Sadiku të dëmtuar. Jam përpjekur të nis një skuadër eksperte, pasi këto kanë rëndësi. Agolli e Lika kanë oshilacione në prezencën në fushë. Nëse jemi një skuadër e plotë, bëjmë mirë siç kemi bërë ndaj Turqisë, Spanjës.

### Shabani i Bajernit te Shqipëria?

Realiteti është, se Shabani nuk ka marrë ende një vendim, kjo është situata. Ai nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Këtë na ka komunikuar familja e tij.

### Egli Kaja në Angli, e keni thirrur?

Nuk e kemi kontaktuar. Kemi shumë lojtarë, mbi 250 lojtarë. Janë edhe shumë që i kontaktojmë. Më bën përshtypje, edukata e lëkundur, pasi sido që të jetë, njeriu përgjigjet, dua të vij apo jo në Kombëtare. As nuk na kthejnë përgjigje.

### Cikalleshi dhe Ramadani nuk janë në listë...

Aty ku mundesha, kam marrë ata lojtarë që kanë minuta.

Për momentin, kam marrë lojtarë me më shumë përvojë, duke shmangur presionin e madh për këto ndeshje. Basha dhe Lilaj, janë në vend të Ramadanit. Cikalleshi ka luajtur pak minuta për momentin.

### Grupi në këto ndeshje...

Jam i kënaqur që ky grup ka bërë mirë. Për sa i përket lojtarëve që luajnë pak, këta lojtarë nuk i përballojnë dot dy ndeshje. Edhe kundërshtarët tanë kanë probleme me të tilla çështje, lojtarë që nuk luajnë. Kjo është situata, unë flas çdo ditë me Grezdën, me Mavrajn. Ky i fundit po ndjek një terapi serioze. Është një lojtar i cili ka përvojë, por mund të luajë vetëm një ndeshje. Për fatin tonë, kjo është skuadra. Punoj çdo ditë, ndryshe nga ç'ka flitet se vij rrallë në Shqipëri. Di gjithçka që ndodh me ta. Të gjitha këto situata duhet të shikohen e vlerësohen. Xhaka sapo është rikthyer nga dëmtimi, por ka një karakter të fortë, ka zjarrin brenda vetes, që na shërben shumë. Edhe Grezda, qoftë me 30 minuta.

### Strakosha apo Berisha?

Problemi i fundit që kam, pasi të dy kanë cilësi, edhe pse Strakosha po luan më shumë. Ky është problemi më i fundit që kam.

### Moduli i lojës...

Pa Roshin, mund të ndryshojë sistemi deri diku. Ata luajnë me një sistem loje. Janë dy ndeshje shumë të ndryshme ajo me Izraelin dhe Skocinë. Këta të fundit të vënë në presion dhe duhet zjarr nga të gjithë lojtarët. Për ne ky kompeticion është i rëndësishëm dhe duhet ta nisim mirë.

### Ndeshjet e radhës...

Janë dy ndeshje të ndryshme. Në Skoci, do të jetë një ndeshje zjarr. Por, për ne ky kompeticion është shumë i rëndësishëm, thelbësor. Duhet ta nisim sa më mirë, kundër Izraelit. Nuk dua t'i rikthehem të harxhoj energji negative me ndeshjet miqësore. Tani jemi të përqendruar tek këto ndeshje zyrtare që kemi..

### Pika më e fortë dhe më e dobët e grupit tuaj...

Kemi një grup të ekuilibruar. Me Izraelin kemi fituar në transfertë, kemi humbur në shtëpi. Me Skocinë, luajmë në një ndeshje të zjarrtë. Nëse kemi grintën, do kemi një

### Duka ka thënë që pres reagonin e skuadrës në shtator. Ju vendos në presion kjo gjë?

Duke qenë se kemi rikuperuar disa lojtarë, nuk ndiej presion. Duhet të japim një sinjal. Gjithçka që kam bërë me eksperimente, kanë mbaruar.

Tani nis historia e vërtetë për Europeanin. Kemi bërë një analizë të plotë me presidentin. Nuk dua të fshihem, për sa i përket momenteve delikate që kam kaluar. Më vjen keq për ata që nuk e kuptojnë, pasi kemi bërë gjëra të mira me Turqinë, Spanjën, Italinë. Tani gjithçka është zëruar, dhe fillon gara e vërtetë.



## Neymari dëshiron kalimin te Chelsea ose Arsenal

Neymari do të dëshiron të një kalim te Chelsea ose Arsenali para Manchester Cityt, nëse do të kalonte në Premier League, sipas "Daily Express". 25-vjeçari është fans i madh i Londrës dhe e ka vizituar kryeqytetin anglez tre deri katër herë në 12 muajt e fundit. Ai ka kontratë me Paris Saint-Germainin deri më 2022, por ka pasur vazhdimisht spekulime se mund të largohet më herët nga Franca.

Mendo  
JETË më të SIGURITË,  
më të MIRË  
dhe  
më të GJATË.

Mendo



+389 2 3288 800  
[www.uniqa.mk](http://www.uniqa.mk)

SIGURIME  
JETË dhe JO-JETË

**DASHI** 21. mars - 20. prill  
Parashikohet një muaj i ri i mbushur me evente interesante për tu rikthyer në lojë, pas një periudhe përhumbje, sidomos në vendin e punës. Dialogu është mjaft i favorshëm dhe do të arrini do të gjeni mjaft mirëkuptim dhe qetësi në dashuri. Në çështjet e biznesit tregohuni të kujdesshëm.

**DEMI** 21. prill - 21. maj  
Duhet të vlerësoni më mirë eksperiencat e reja në punë ose eksperimentet e rëndësishme për të rinovuar pozicionin tuaj. Së fundmi keni qenë tejet të shkëputur dhe për këtë arsye duhet të përvishni mirë mëngët për të rikuperuar. Kjo e diel favorizon takimet e mbrëmjes.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor  
Në këtë moment ka disa propozime të shkëlqyera të cilat duhet ti vlerësoni me vëmendjen më të madhe. Ndonëse e përkohshme, kjo situatë e paqëndrueshme emocionale mund të shkaktojë disa keqkuptime në dashuri, ndaj jini më të qartë në raport me partnerin/en tuaj.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik  
Nga pikëpamja sentimentale kjo do jetë një ditë e mbushur me pasion dhe kjo në sajë të rigjetjes së bashkëpunimit me partnerin/en tuaj. Edhe ata që janë vetëm, mund të kenë takime interesante. Tregohuni të gatshëm të përfshihen në bashkëpunime të reja në vendin e punës.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht  
Mos hezitoni që ta lini veten të lirë në dashuri, pasi do të keni mundësi shumë të mira për të rindezur ndjenjat tuaja. Në vendin e punës duhet të jeni më të gatshëm të merrni një rol me shumë përgjegjësi.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator  
Cjatë kësaj të diele këshillohet që të ruani qetësinë dhe ta kaloni ditën në qetësinë maksimale në shoqërinë e familjes tuaj. Së fundmi jeni lodhur shumë, ndaj duhet të shmangni tensionet dhe të mendoni vetëm për tu qetësuar.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor  
Kjo është një periudhë mjaft e rëndësishme për ata që kanë dëshirë të riafrohen me partnerin/en, apo të përfshihen në histori të reja dashurie. Në vendin e punës duhet të jeni më kurajoz, pasi do të jetë pikërisht vendosmëria dhe guximi juaj ai që do ju lejojë të arrini një objektiv vendimtar.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor  
Keni marrë përsipër përgjegjësi të mëdha, të cilat do ju lejojnë që të merrni rezultate po aq të mëdha. Do të jeni shumë të përqendruar dhe kjo gjë do ju lejojë që të vlerësoni disa strategji interesante. Ajo që këshillohet për ju, është që të mundoheni të pushoni më shumë në mbrëmje.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor  
Mundohuni që të mos jeni shumë të pavendosur dhe konfuz në dashur, për shkak se kjo sjellje juaj mund të acarojë partnerin/en dhe të minojë stabilitetin në çift. Ka disa zgjedhje të rëndësishme të cilat duhen marrë me kujdes, lidhur me çështjet ekonomike.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar  
Parashikohet një ditë e cila do ju gjejë të përfshirë në gjetjen e zgjidhjeve për konflikte të vogla në vendin e punës. Mundohuni të tregoheni sa më diplomat dhe mos u impononi shumë ndaj bashkëpunëtorëve tuaj. Në këtë moment keni nevojë që të rrethoheni nga më shumë aleatë.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt  
Kjo fundjavë do të jetë mjaft e turbullt dhe do ju gjejë tejet nervoz dhe të acaruar, ndoshta për shkak të disa mosmarrëveshjeve në punë ose në familje. Jini më të sigurtë më veten tuaj dhe shmangni maksimalisht kapacitetin tuaj. Në dashuri priten përgjigje të mira.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars  
Parashikohet një ditë e cila do ju lejojë që të zbuloni disa anë të cilat i kishit lënë pas dore së fundmi, për shkak të punës së tepërt. Parashikohen nisma të mira lidhur me të ardhmen. Këshillohet që të mendoni më shumë për veten dhe nevojat tuaja.

<b>Mensur Mamuti</b>	GADISHULL EGJIPTIAN MIKRO-SHTETI NË FOTO	<b>S</b>	RAJON NË TANZANI	VADITJET	ISHULLI I LINDJES SË THEMELUESIT TË SHTETIT NË FOTO (SOT NË KROACI)						
NJË LIDHËZ QË SHPREH NJË KRAHASIM TË PËRAFERT											
VARKA											
ISH POLITIKANI SIRIAN, AL-BAKRI											
VEGËL ANIM, PËRKULJE NË NJË ANË									NJË NUMËR RENDOR		
<b>V</b>											
RUMANIA		ENTERPRISE EUROPE NETWORK VERTIKALISHT									
INTERNET PROTOCOL					NYJË E PËRPARME TEK EMËRAT E MBIENRAT KLUBI I GRACIT TË AUSTRISË						
QYTET NË SERBI MALI, PRANË TË CILIT GJENDET SHTETI NË FOTO						AZOTI NUOHËS TË ERGONOMISË	INSTITUTE FOR SOCIAL ECOLOGY	POETI KROAT, UJEVIQ	ANGSTREMI	KRUESË GJIGANTE NDREQA RREGULLIMI	<b>M</b>
<b>M</b>											
<b>KOHA</b>	NJERIU I FORTË SI GUR KËSHITJELLA NË FOTO									DOMAIN NAME BURRË TRIM E BUJAR	
PROFESIONI I SHËN MARINIT, THEMELUESIT TË SHTETIT NË FOTO ATAKOJ											
<b>S</b>							PJESËMARRJA NË FILM	KRIJIM ARTISTIK KALLAJI			
AUSTRIA		PLOGËTTË THAJ									
ITRIUMI					AUTORI KROAT, ZHUPANÇIQ RIFAT KUKAJ				IRIDIUMI ASTATI		
QË BIRUJN NGANENTOKA									AMERICIUMI METRI		1000 ROMAK
KASAFORTË											

ZGJIDHJET: S, SIKUR, ANIJA, NASIB, MJET, VAISJE, R, EEN, IR, TË, NISH, N, M, MONTE TITANO, GURËSI, DN, GURGDHENDËS, SULMOJ, ART, A, INERCITË, IT, OTON, IR, TERMAL, AM, ARKE, IMTIM.

shumë i lehtë

Sudoku

mesatar

	2		4			5	7				6			3			1
7	4		8		3			1	1	3			8				
		5	9						9			1	5		6		
		9				7	5	4		5			6				
				1								9		1			
2	5	4						3					7				1
5					9	2					5	6	2				4
3			1		5		4	9					3				7
	7				6		1		4						5	9	3

Shumë i lehtë: 923461578, 746853921, 815927463, 198632754, 637514892, 254798136, 561349287, 382175649, 479286315. Mesatar: 526793841, 134286759, 978154623, 251368497, 783941265, 649572318, 395627184, 8122439576, 467815932.

Publicitet

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, trymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

Kërkoj punëtorë për në Suedi të moshës 60 deri 65 vjeçare për kryerjen e punëve shtëpiake me mundësi për rregullimin e dokumenteve suedeze në bazë të kurorëzimit. Telefon për kontakt 0046760974613.



## Këto janë dallimet midis trurit të majtë dhe trurit të djathtë

Disa njerëz e përdorin më shumë pjesën e majtë të trurit dhe disa të tjerë të djathtën. Ekspertët thonë se mënyra se si njerëzit mendojnë dhe sillen ndikohet nga pjesa e trurit që ata përdorin më shumë. Truri është një organ kompleks dhe shumë produktiv. Përbëhet nga 100 miliardë qeliza dhe peshon vetëm tre kilogramë, shkruan Medicalnewstoday. Ana e majtë dhe e djathtë e trurit janë të lidhura me një numër të madh të fibrave nervore. Në një tru të shëndetshëm, të dy palët komunikojnë me njëri-tjetrin. Ekspertët besojnë se secili njeri ka një anë të trurit që është më dominues që përcakton personalitetin, mendimet dhe sjelljet e tyre.

### Njerëzit që e përdorin pjesën e majtë të trurit janë me tepër:

- Analitikë
- Logjikë
- Të orientuar në fakte dhe detaje
- Numerikë

### Ndërsa njerëzit që e përdorin pjesën e djathtë të trurit njihen si:

- Krijues
- Mendjehapur
- Në gjendje t'i kuptojnë ngjarjet e mëdha
- Instinktivë

## MOS FLINI ME TELEFONIN AFËR

Një studim i bërë nga Departamenti i Shëndetësisë në Kaliforni tregon se disa shqetësime shëndetësore mund të lidhen me përdorimin e celularit, duke filluar nga problemet me shëndetin mendor dhe riprodhues, deri në rritjen e rrezikut për zhvillim të kan-

cerit. Celularët emetojnë energji të radio frekuencave, kur ato dërgojnë apo marrin sinjale drejt dhe nga stacionet bazë të telefonisë celulare. Disa shkencëtarë besojnë se ekspozimi i gjatë ndaj tyre mund të rrezikojë shëndetin e njeriut. Fëmijët janë më të riskuar ndaj

energjisë së valëve elektromagnetike, duke qenë se mund të depërtojë më lehtë tek truri i fëmijëve se sa të rriturit.

Studime të mëparshme kanë treguar se përdorimi i celularëve më orë të tëra mund të shkaktojë tumore në tru dhe vesh.



## Gati iPhone 6.5, më i madhi i realizuar ndonjëherë!

Versioni Plus i përditësimit të iPhone X do të shoqërohet nga një model 5.8" dhe një pajisje "ekonomike" 6.1" me një ekran LCD, por me teknologjinë Face ID. Megjithatë, ky i fundit mund të arrijë me një vonesë të vogël në treg. Pak javë na ndajnë nga eventit ku Apple do të lançojë iPhone-t e rinj dhe po marrin formë detajet e fundit të pajisjeve. Siç është parashikuar gjerësisht, modelet e ardhshme do të jenë tre: një nga 5.8 inç që do të përfaqësojë evolucionin e sotëm të iPhone X, një i dytë nga 6.5 që konsiderohet si versioni i saj Plus dhe që do të jetë smartfoni me përmasa më të mëdha që ka realizuar ndonjëherë



nga Apple deri tani. Së fundi, do të vijë edhe një i tretë iPhone 6.1, i ashtuquajtur "model ekonomik" që përbën risinë e vërtetë në shtëpinë e Apple të këtij viti. Ndryshe nga dy të parët që do të kenë një ekran OLED, ky i fundit do të mbajë një LCD, por do të vazhdojë të mbajë të njëjtën vendosje të iPhone-it pa kufij dhe me praninë e vijës që strehon sensorët

për Face ID. Dallimet e tjera do të jenë prania e një kame-re të dyfishtë të pasme për dy iPhone të parë, ndërsa do të ketë vetëm një për modelin ekonomik që ndër të tjera do të ketë një kornizë alumini dhe jo çelik inox. Për më tepër, ky i fundit do të mbajë slotin për një Sim, ndërsa modelet e tjera do të jenë të dyfishta Sim, të paktën në disa tregje.

## FSHATI I VOGËL QË KËRKON TË NDALUJË MACET



Në një fshat në Zelandën e Re, së shpejti mund të mos lejohen më macet. Ky është propozimi i bërë nga Këshilli për Ambientin në rajonin Southland drejtuar banorëve të Omauit, qytezë e vogël që ndodhet në ekstremin perëndimor të vendit. Qëllimi është ai për të mbrojtur oazin natyror të territorit. Sipas tyre, macet janë përgjegjëse çdo vit për vdekjen e miliona

zogjve dhe gjitarëve të vegjël, një shfaqje që kërcënon biodiversitetin. Projektligji, i quajtur "Plani i menaxhimit të dëmeve" dhe i adresuar banorëve të fshatit të Zelandës së Re, parashikon që të gjithë pronarët e maceve duhet të sterilizojnë dhe mikroçipojnë kafshët. Shkelësit do të njoftohen dhe do të paralajmërohen, por në rast të shkeljeve të mëtejshme, autori-

tetet mund të vendosin të sekuestrojnë kafshën. Dokumenti, siç raportohet nga BBC, do të diskutohet në vjeshtë dhe qytetarët do të kenë kohë deri në tetor për të shprehur mendimin e tyre mbi strategjinë që do të miratohet. Vdekja e disa mostrave do të kërcënojnë mbrojtjen e biodiversitetit të këtij cepi të vogël të parajsës së Zelandës së Re.

KALENDARI HISTORIK 3 SHTATOR

301 - San Marino, një nga popujt me numër më të vogël dhe republika më e vjetër në botë që ende ekziston themelohet nga Shën Marini.

1189 - Riçardi I Zemërluani kurorëzohet mbret në Westminster.

1650 - Beteja e Dunbarit: Anglia kundër Skocisë.

1803 - Shkencëtari anglez John Dalton filloi të përdorë simbole për të prezantuar atomet e elementeve të ndryshme.

1852 - Kryengritja kundër herreje në Stokholm.

1891 - Mbledhësit e pambukut themelojnë bashkësi dhe organizojnë grevë në Teksas.

1914 - Princi Wilhelm von Wied largohet nga Shqipëria.

1939 - Britania e Madhe dhe Franca shpallin luftë Gjermanisë pas pushtimit të Polonisë.

1944 - Trupat franceze lirojnë Lionin.

2004 - Përfundon masakra në shkollën në Beslan me vdekje të rreth 344 persona, shumica mësime dhe nxënës.

Qentë janë të vetmet kafshë jo-primatë që i shohin njerëzit në sy. Ata kërkojnë kontaktin me sy nga njerëzit, por jo prindërit e tyre biologjikë. Dhe, ndryshe nga kafshët e tjera të zbutura, qentë vrapojnë drejt pronarëve të tyre, kur janë të frikësuar apo shqetësuar - ndryshe nga kuajt dhe macet që largohen.



Physalis Alkengi që rritet kryesisht në Kinë dhe Japoni, është cilësuar si lulja simbol e "jetës brenda vdekjes". Ajo lulëzon në dimër dhe thahet në pranverë, duke zbuluar fruta të ndritshme të kuqe që jetojnë brenda saj.



### PANIKU

Nxënës të shkollës fillore po ecnin rrugës, kur papritmas shohin një qift të sapomartuarish duke dalë nga kisha. Njëri nga fëmijët më çapkën i thotë shokëve: "Ja se çfarë është paniku!" I afrohet dhëndrit, ia kapë për dore dhe i thotë: "Tung babi!"



"Babai im më tha se ka dy lloj njerëzish në këtë botë: ata që japin dhe ata që marrin. Ata që marrin hanë më mirë, por ata që japin flenë më mirë". (Marlo Thomas)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS